



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.07.2019, ora 10:00

#### Drejton mbledhjen:

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për mbrojtjen civile”.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për rininë”.

#### Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Ediola Braha, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Korab Lita dhe Elena Xhina

#### Mungojnë:

Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Damian Gjoknuri, Alban Zeneli, Elda hoti dhe Tom Doshi

#### Të ftuar:

Bardhylka Kospiri - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale

Miranda Pashaj – Drejtore e SHSSH-së në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Erviola Nelaj - Specialiste në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Haki Çako - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC) në Ministrinë e Mbrojtjes

Ismail Shehu - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

Maksimiljan Dhima - Drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit, pranë DPEC-së në Ministrinë e Mbrojtjes

Zamira Gjini – Drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Erzen Tola – Drejtor i Programimit Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Florian Nurçe - Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Matilda Bulku – Specialiste e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Bekim Murati – Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në Ministrinë e Brendshme

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me rendin e ditës. Sot kemi një ditë pune të ngjeshur në komision, pasi kemi shqyrtimin e projektligjit “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtimin e projektligjit “Për mbrojtjen civile” dhe shqyrtimin e projektligjit “Për rininë”. Për të tria këto projektligje Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi. Këto projektligje është menduar të kalojnë në seancën plenare të datës 18 korrik, ndaj ne si komision për dhënie mendimi do të duhet t’i kalojmë sot, me qëllim që t’i japim kohë komisionit përgjegjës të marrë raportin tonë, por edhe sugjerimet dhe komentet që komisioni ynë do të bëjë për secilin projektligj.

Fillojmë me projektligjin “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Relatore e këtij projektligji është kolegja Klotilda Bushka. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Shëndetësisë, zonja Bardhylka Kospiri, zëvendësministre.

Zonja Kospiri, mirë se keni ardhur!

Zonja Miranda Pashaj dhe zonja Erviola Nelaj, specialiste në Ministrinë e Shëndetësisë. Unë ju prezantova për të qenë korrekt me atë çka më ka shkruar stafi im. E vlerësoj pjesëmarrjen e zëvendësministres Kospiri në Komisionin e Ligjeve dhe pa humbur kohë po ia kaloj fjalën për të na bërë një prezantim të shkurtër të këtij projektligji për kolegët deputetë. Më pas fjalën e ka kolegja Bushka.

Fjala për ju, zonja Zëvendësministre.

**Bardhylka Kospiri** – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Ne kemi sjellë sot në komision ligjin e ri për asistencën sociale, i cili vjen me një koncept dhe vizion të ri si garantim i mbështetjes për familjet dhe individët në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara sociale dhe ekonomike. Ky projektligj vjen pas një pune shumë të madhe të implementimit të një reforme të suksesshme të ndihmës ekonomike. Ne si Ministri e kemi realizuar këtë program nëpërmjet modelit të ri të ndihmës ekonomike me mbështetjen e Bankës Botërore me një projekt jo pak sfidues. Sfidat gjatë një viti janë tejkaluar dhe sot kemi një sistem të konsoliduar transparent

dhe të digjitalizuar aplikimi, që shtrihet në të gjithë Shqipërinë; kemi kritere gjithëpërfshirëse dhe jopërrjashtuese, duke lehtësuar procesin dhe duke thjeshtësuar dokumentacionin; kemi masë mesatare të rritur të ndihmës ekonomike për çdo familje, e cila plotësohet vazhdimisht me subvencione shtesë; kemi shënjestrim dhe mbulim më të mirë për familjet në nevojë; kemi buxhet dyfish të shtuar për pushtetin vendor dhe alternativa të reja financimi për kategoritë në nevojë, si dhe për anëtarët e skemës së ndihmës ekonomike, duke i prioritetizuar në punësim jo vetëm nga burimet e disponueshme të bizneseve dhe shërbimeve publike, por edhe nëpërmjet incentivave dhe fondeve të dedikuara për ndërmarrjet sociale.

Kujdesi ndaj familjeve të skemës së ndihmës ekonomike është, gjithashtu, pjesë e një programi të plotë që kemi në proces, atij të përkujdesit shoqëror ku përfshihen të gjitha përfitimet që jepen si për familjet, ashtu edhe për individët në nevojë, nëpërmjet shërbimeve sociale alternative të ofruara në çdo bashki nëpërmjet fondit social.

Projektligji përmbledh tri programe të pagesave në kesh, atë të ndihmës ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar dhe mbështetjen financiare për foshnjat e sapolindura. Skema e ndihmës ekonomike ka pasur një panoramë progresive në lidhje me numrin e familjeve përfituese, ku aktualisht 95% e aplikuesve janë përfitues dhe numri i përfituesve është rritur me 92% krahasuar me fillimin e vitit 2018. Aktualisht në total përfitojnë 66 733 familje në skemën e ndihmës ekonomike, duke përfshirë edhe 2648 familje përfituese nga fondi 6% i deleguar i bashkive.

Gjatë një viti kemi ndjekur dinamikën e skemës, sipas së cilës 80% e familjeve përfituese në nivel kombëtar janë kontrolluar për pranueshmërinë e tyre, duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit. 90% e njësive të pushtetit vendor në nivel kombëtar përdorin sistemin elektronik për përzgjedhjen e përfituesve, 75% e rasteve të dyshuara për mashtrim e gabime në skemën e ndihmës ekonomike janë verifikuar nga inspektorët socialë në përputhje me politikën dhe legjislacionin e rishikuar të sanksioneve. Por, paralelisht plotësuam kuadrin e zbatimit të saj, duke krijuar terren të qëndrueshëm e duke krijuar procedura të reja kontrolli të digjitalizuara, duke ngritur një sistem monitorimi transparent dhe efikas nëpërmjet planifikimit të një profili risku të ndihmës ekonomike, duke miradministruar pagesat e drejtpërdrejta të familjeve, duke i monitoruar ato nëpërmjet lidhjes me thesarin, bankat e postën, si dhe duke lajmëruar e sensibilizuar çdo qytetar në çdo cep të Shqipërisë. Mbi të gjitha punonjësit tanë të Shërbimit Social Shtetëror kanë ndihmuar dhe mbështetur çdo familje të përjashtuar për një gabim njerëzor nga sistemi.

Duke qenë të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm që kjo skemë kërkon përmirësime, duke u nisur edhe nga problematikat e terrenit të përcjella në Ministri nga Shërbimet Sociale Shtetërore dhe nga punonjësit tanë apo edhe nga vetë administratorët shoqërorë na rezulton se duhej t'i adresonim menjëherë dhe plotësisht në një kuadër të ri ligjor këto problematika.

Për këto arsye u hartua ky projektligj i ri, të cilin po e diskutojmë sot, i cili sjell disa risi ndër të cilat: pagesën në masë të plotë të ndihmës ekonomike, duke hequr tavanin, i cili aktualisht ka qenë deri në 8000 lekë. Pra, për familjet që vlerësohen nga sistemi që duhet të përfitojnë për shkak të numrit të madh të anëtarëve përfitojnë masë më të madhe përfitimi ato nuk janë më të kufizuara dhe e përfitojnë këtë masë, duke mos u kufizuar më nga taveni prej 8000 lekësh. Numri i llogaritur deri tani kap shifrën 2979 familje me më shumë se 6 anëtarë, të cilët do të përfitojnë nga heqja e këtij kufiri, kjo gjithmonë duke u bazuar në parimin tonë që të kemi mbulim dhe mbështetje financiare për çdo familje në nevojë që është pjesë e ndihmës ekonomike.

Një tjetër risi është thjeshtimi i procedurave të panevojshme për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar, pasi shmanget roli i këshillit bashkiak, i cili, në të shumtën e rasteve, për shkak të mosmbledhjes në kohë, pengonte dhënien e përfitimeve, duke penalizuar qytetarët. Në këtë projektligj këshilli bashkiak nuk do të ketë më tagër të miratojë listat e përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike dhe as të personave me aftësi të kufizuar, të cilët përfitojnë në bazë të vendimit të komisionit. Në këtë mënyrë shmanget një procedurë burokratike e panevojshme, e cila nuk do të na sjellë më pagesa apo vendime të marra në kohë të vonuar, të cilat penalizojnë qytetarët vulnerabël. Roli i këshillit bashkiak për efekt të ndihmës ekonomike tashmë do të fokusohet vetëm në përcaktimin e kritereve dhe vendimmarrjen për familjet që trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar prej 6% të ndihmës ekonomike, për të cilat këto familje nuk kanë mundur të zgjidhen nëpërmjet sistemit të drejtpërdrejtë të pikëzimit.

Një tjetër risi është se kemi përcaktuar një kufizim kohor të qëndrimit në skemën e ndihmës ekonomike me synim që të nxisim integrimin në jetën shoqërore të familjeve nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit, me qëllim që kjo skemë të mos përdoret si mekanizëm përfitimi, e cila mund të çojë në papunësi të zgjatur të anëtarëve të këtyre familjeve, si dhe për ta kthyer atë në një skemë aktive. Nga ana tjetër projektligji shmang abuzivitetin me skemën e ndihmës ekonomike, duke i nxitur dhe duke i orientuar qytetarët të përfshihen në programet e formimit profesional për të marrë një profesion, përfshirjen në programet e këshillimit për punësim, si dhe punësimin e tyre nëpërmjet ofertave të punës që disponojnë zyrat e punës, duke i

hapur rrugë krijimit të një strategjie daljeje apo një programi të integritimit në tregun e punës të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive të punës, që janë përfitues në familjes e ndihmës ekonomike.

Aktualisht, pas miratimit të ligjit, një paketë e plotë me metodologjinë, mekanizmat koordinues, udhërrëfyesit dhe protokollet do të hartohet nga Ministria për të adresuar çdo qytetar të ndihmës ekonomike drejt punësimit të qëndrueshëm.

Një tjetër risi ka të bëjë me faktin që kemi parashikuar përjashtim nga detyrimi i paraqitjes pranë zyrave të punës për të kërkuar punë gjatë kohës që janë studentë personat e familjes të ndihmës ekonomike, me qëllim që familja të mos penalizohet për përfitimin e ndihmës ekonomike. Pra, deri më sot ka qenë që duhej të paraqiteshin edhe këta anëtarë të familjes për t'u punësuar dhe familja penalizohej nëse ata nuk paraqiteshin, ndërsa sot ky detyrim është hequr.

Gjithashtu, vazhdojmë të insistojmë që ndihma ekonomike duhet të tërhiqet, që do të merret në dorëzim nga gratë në familje, ky përcaktim bëhet me qëllim që ndihma ekonomike të menaxhohet dhe përdoret për nevojat ekonomike të familjes dhe fëmijëve dhe të mos përdoret për qëllime të tjera.

Ndërkohë, projektligji parashikon edhe raste që përjashtohen nga skema e ndihmës ekonomike, si edhe afatet e përjashtimit nga e drejta për aplikim dhe përfitim, të cilat variojnë nga gjashtë muaj deri në një vit. Pra, për familjet që refuzojnë ofertat e përshtatshme të zyrave të punës për punë, që punësohen dhe ndërpresin marrëdhëniet e punës pa shkaqe të arsyeshme, që kanë kryer më shumë se një deklaram të rremë ose kur rezultojnë me të ardhura dhe kushte shumë të mira ekonomike, përjashtimi nga skema e ndihmës ekonomike pa të drejtë riaplikimi, parashikojmë të jetë për një periudhë 1-vjeçare.

Duke pasur një sistem të dixhitalizuar të ndihmës ekonomike, procedura e aplikimit realizohet pranë administratorit shoqëror të njësisë administrative të vendbanimit të qytetarit nëpërmjet përdorimit të regjistrimit elektronik, që lehtëson shumë procedurat.

Në lidhje me temën e nxehtë të sistemit të pikëzimit projektligji përcakton se transparenca e formulës së unifikuar të pikëzimit do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në nivelin e varfërisë në vend.

Risi tjetër e këtij projektligji është se parashikon skemën e pagesave në kesh për aftësinë e kufizuar. Nga kjo skemë sot përfitojnë 163 mijë e 837 përfitues, nga të cilët 70 mijë e 162 janë persona me aftësi të kufizuar pa histori punësimi dhe këtu përfshihen 12 mijë e 291 të verbër dhe

6611 paraplegjikë, 19 mijë 489 kujdestarë dhe 74 mijë e 336 invalidë pune, që marrin një shtesë mbi pensionin e invaliditetit.

Aktualisht skema e aftësisë së kufizuar mbështet me pagesa kesh personat me aftësi të kufizuara, por skema aktuale nuk ndërvepron me skema të tjera, të cilat kanë për qëllim të integrojnë në jetën shoqërore personat me aftësi të kufizuara, për këtë arsye ligji parashikon reformën e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të cilën së fundi është miratuar nga Këshilli i Ministrave dokumenti politik me vendimin nr. 830.

Kjo reformë synon rishikimin e sistemit aktual të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, i cili është konceptuar që në nënshkrimin dhe ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim, pra që në fillimet e këtij projekti për financimin e projektit të reformimit të asistencës sociale.

Gjithashtu kjo reformë vjen në përputhje me konventat e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe me ligjin për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, sigurisht dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të OBSH-së dhe klasifikimin ndërkombëtar të funksioneve.

Kjo reformë është e rëndësishme, së pari, për respektimin e praktikës bashkëkohore ndërkombëtare të shndërrimit të vlerësimit mjekësor në vlerësim biopsikosocial; së dyti, për rritjen e eficiencës së vlerësimit duke krijuar mekanizma administrative që edukojnë ndjeshëm shkallën e abuzimit, rrisin besueshmërinë dhe ulin koston e vlerësimit; së treti, për përmirësimin e shërbimit për qytetarët, ndërsa ristrukturimi i pagesave të aftësisë së kufizuar parashikohet në këtë projektligj për të realizuar një sistem të ri pagesash që reflekton shkallën e nevojave funksionale të personave me aftësi të kufizuar dhe nxit e mbështet integrimin e tyre në shoqëri. Kjo është konsideruar si domosdoshmëri prej disa vjetësh për shkak se modeli aktual i vlerësimit është i fragmentarizuar, jo efektiv, i ndryshëm për grupe të ndryshme të aftësisë së kufizuar, i komplikuar, burokratik, i vështirë për t'u menaxhuar nga pikëpamja administrative dhe i padixhitalizuar. Ky sistem vlerësimi nuk ndërvepron me skema të tjera integruese si punësim, shërbime sociale dhe arsimim.

Këto problematika kanë nxitur rastet e abuzivitetit, nxjerrjen e skemës jashtë kontrollit dhe për pasojë një rritje të fondeve të mbrojtjes sociale, ku pjesën më të madhe e zë aftësia e kufizuar në raport me ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore.

Ky projektligj parashikon sistemin e ri të vlerësimit në modelin biopsikosocial, i cili është testuar në Tiranë, deri në vitin 2021 do të shtrihet në Elbasan dhe Durrës, dhe deri në vitin 2024 në të gjithë vendin. Ndërkaq skema aktuale e aftësisë së kufizuar është një skemë e cila do të vazhdojë të aplikohet në të gjithë vendin deri në momentin e shtirjes së reformës së aftësisë së kufizuar.

Një tjetër risi te ky ligj është edhe futja e konceptit personal.

**Ulsi Manja**- Ju lutem, zonja Kospiri, mund ta përmbledhni që t'iu japim mundësi kolegëve të shprehen!

**Bardhylka Kospiri** - Një tjetër risi është futja e ndihmës personal.

Së treti, projektligji parashikon edhe pagesat që jepen për ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura që është konceptuar si një paketë e plotë duke parashikuar edhe mekanizmat e financimit dhe garantimin e fondeve.

Projektligji parashikon mënyrën e financimit të programeve të asistencës sociale, kontrollin, sanksionet dhe të drejtën e ankimimit, rolin dhe përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse dhe shërbimit social shtetëror në nivel rajonal dhe njësitë e pushtetit vendor, financimin e programeve të asistencës sociale, të cilat realizohen tërësisht nga buxheti i shtetit dhe të drejtën e kategorive përfituese të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, që të përfshihen persona ekonomikisht jo aktiv në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

Financimi i këtij projekti është fondi i pagesave të ndihmës së aftësisë së kufizuar, pra efekti financiar i projektligjit është fondi i pagesave të ndihmës ekonomike të kufizuar. Parashikimi për vitin 2019 është 22,5 miliardë, nga të cilat 20,5 miliardë është ndihma ekonomike e pagesës për aftësinë e kufizuar dhe shërbimet shoqërore dhe 2 miliardë për financimin për foshnjat e porsalindura.

Ju ftoj ta votoni këtë projektligj pasi risitë e tij ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së familjeve në nevojë dhe individëve me aftësi të kufizuar për integrimin e tyre denjësisht në shoqëri!

**Ulsi Manja**- Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Klotilda Bushka për të bërë një përmbledhje të gjetjeve të këtij projektligji si relatore dhe më pas pyetje dhe diskutime nga kolegët dhe votimi.

**Klotilda Bushka**- Faleminderit!



Faleminderit, zonja Kospiri!

Ju bëtë një prezantim shterues të nismës që ka sjellë Këshilli i Ministrave. Më duhet ta them për të gjithë kolegët që Ministria e Shëndetësisë është tashmë në nismën ligjore të katërt ose të pestë në parlament dhe ju përgëzoj për konsistencën në të gjitha aktet që keni sjellë këtu, sepse keni bërë një harmonizim të ligjeve të miratuara deri tani me njëri-tjetrin, duke gërshetuar politikat e mbrojtjes sociale me politikat e punësimit dhe duke pasur si qëllim gjithmonë nxjerrjen nga skema e ndihmës ekonomike të individëve, nëse atyre u garantohet një mundësi punësimi, kështu që në vazhden e këtyre që keni bërë deri tani më duhet t'ju them që edhe projektligji që jemi duke diskutuar është në të njëjtin nivel cilësie dhe projektligji që jemi duke diskutuar është në të njëjtin nivel cilësie dhe vëmendje të shtuar ndaj grupeve në nevojë për të marrë më shumë shërbime.

Do të doja të bëja shumë shkurt një sqarim për opinionin publik. Ky është një ligj, i cili do të shfuqizojë ligjin për shërbimet shoqërore, që është në fuqi që nga viti 2005 dhe vetë koha e ka zbehur tashmë efektivitetin e atij ligji. Vetë dinamika e zhvillimit të shoqërisë dhe lindja e problemeve të reja sociale ose mundësitë e reja për t'i nxjerrë njerëzit nga situatat e varfërisë ose të kushteve të veçanta sociale janë ndryshuar dhe, nga ana tjetër, edhe strategjitë e qeverisë, sa i takon faktit të orientimit të tregut të punës nëpërmjet fuqizimit të individëve me punë dhe jo me ndihmë, me para nga shteti, kanë bërë që të mendohet për një reformë të thellë në shërbimet sociale, pjesë e së cilës është edhe ky akt.

Kështu që mendoj se jemi në kohë për një projektligj të tillë, madje mund të themi se jemi të vonuar, sepse tashmë edhe konsolidimi i shërbimeve sociale dhe i ndihmës që shteti jep për kategoritë e veçanta është i tillë që mund të plotësojë më shumë nevoja se më parë.

Asistenca sociale, sipas këtij projektligji, do të përfshijë ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura, përfitime të tjera për kategori të ndryshme. Pra, për opinionin publik ky do të jetë objekti i ligjit.

Përfituesit e ndihmës ekonomike, si pjesë e asistencës sociale, do të jenë familjet në nevojë, të cilat nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme; do të jenë jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore. Arsyeja pse e përmend këtë është, sepse nga praktika shumë herë edhe në grupin e aleancës “Miq të Fëmijëve” ka lindur problemi që jetimët, të cilët janë në institucionet e kujdesit shoqëror i kanë një pjesë të madhe të shërbimeve nga shteti, ata që nuk janë në kushte të tjera, i kanë të cingëruara shërbimet, sepse kemi parashikime të mangëta në legjislacionin që ka qenë në fuqi dhe duhej të bëhej jo vetëm një parashikim i saktë

në legjislacion, por edhe buxhetimi, edhe shtesa e shërbimeve. Mënyra sesi parashikohet në këtë projektligj në mënyrë të zgjeruar i adreson ato shqetësime që janë ngritur në vite, më vjen mirë që janë bërë prezente edhe ato shqetësime që janë ngritur në mbledhjet e grupit të aleancës “Miq të Fëmijëve”. Subjekt përfitues do të jenë edhe prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh që u përkasin familjeve në nevojë, viktimat e trafikimit, janë gjithashtu grup, i cili përfiton. Përfitimi për këto grupe vjen pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror deri në çastin e punësimit të tyre. Kjo është e rëndësishme të theksohet, sepse sot shteti shqiptar ofron shërbime për kategorinë e viktimave të trafikimit në institucionet e përkujdesit shoqëror dhe në momentin që këto viktimat dalin nga gjendja e riskut dhe përpiqen të integrohen sipas politikave që ka shteti në jetën reale, në tregun e punës dhe në jetën shoqërore, do të kenë nevojë të mbështeten nga shteti dhe për këtë arsye në ligjin “Për asistencën sociale” janë kategori përfituese të veçanta.

Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare për periudhën e vlefshmërisë së “urdhrit të mbrojtjes” ose “urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes” që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesit shoqëror do të jenë gjithashtu përfitues të ndihmës ekonomike.

Më vjen mirë të theksoj faktin se me ndryshimet që iu bënë legjislacionit për mbrojtjen e marrëdhënieve familjare dhe për mbrojtjen e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare të gjitha parashikimet e reja për “urdhrit të mbrojtjes” janë konsistente për sa u takon shërbimeve që marrin viktimat, në mënyrë që të bëhet e plotë paketa e mbrojtës që përfitojnë këto viktimat.

Subjekt përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar vazhdojnë të mbeten si gjithmonë paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen me vendim të komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkakut dhe nga mosha, personat me aftësi të kufizuar të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë, personat me aftësi të kufizuara të deklaruar si të tillë, me vendim të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Këtu më duhet të ndalem, sepse për herë të parë janë rregulluar edhe kompetencat e atyre që të gjithë i njohim: KEMP-eve, sepse kemi pasur gjithmonë ecejake të qytetarëve nëpër zyra të ndryshme për të përfituar një KEMP, të cilin nga pikëpamja shkencore e përfitonin, por nga pikëpamja e procedurave mbeteshin dyerve të këtyre që i quanin “KEMP”-e.

Sot me këtë projektligj që sjell qeveria i ka bërë të qarta kompetencat e institucioneve, ka thjeshtëzuar procedurat për marrjen e vendimeve përkatëse që përcaktojnë aftësinë në punë

dhe janë të qarta rolet e të gjitha institucioneve të shtetit, duke filluar që nga ministria përgjegjëse për Shëndetësinë dhe deri tek administratori social në nivelin vendor në bashki. Pra, gjithsecili i ka të qarta kompetencat e tij të parashikuara në ligj. Procedurat janë të thjeshta dhe qytetari duhet vetëm të paraqesë raportin mjekësor që merr te mjeku përkatës. Të gjitha procedurat në kuadrin e deregullimit i bëjnë vetë institucionet, në mënyrë që personi përfitues të mos endet dyerve dhe periudha për të përfituar të jetë më e gjatës sesa ajo e përfitimit ose të mos realizojë dot të drejtën e tij dhe të humbasë interesin për të përfituar një pension të caktuar. Keni parasysh se flasim për kategori në nevojë, flasim për persona me aftësi të kufizuara, për persona me një nivel të caktuar ekonomik për të përballuar jetesën. Kjo është risia e ligjit.

Edhe invalidët e punës, të cilët janë përcaktuar si të tillë me vendim të komisionit përkatës janë ata që përfitojnë pensionet e invaliditetit dhe shtesat mujore mbi të. Ndërsa subjektet përfitues të ndihmës së menjëhershme që është një kategori tjetër përfituese sipas ligjit janë ato që përfitojnë bonusin e bebeve. Deri më sot bonusi i bebes ka qenë i rregulluar me akte ligjore dhe nënligjore, por në ligjin “Për asistencën sociale” bëhet i plotë parashikimi se kush përfiton, sa është masa, si dhe të gjitha procedurat që ndiqen. I gjithë qëllimi i bonusit të bebes është si për të ndihmuar familjet që ta përballojnë ardhjen në jetë të një fëmije me lehtë sipas mundësisë që ka shteti, por edhe për të rritur numrin e lindjeve në vendin tonë, në mënyrë që të bëjmë më të re moshën e popullsisë.

Këto janë pak a shumë rrisitë. Ndërkohë, më duhet të shtoj edhe një element tjetër të cilin e vlerësoj dhe besoj se kolegut tonë zotit Sinaj do t’i plotësohet kërkesa e tij e kahershme, që e ka paraqitur edhe me një amendim ligjor,. Ai ka kërkuar gjithmonë që në ligjin “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të shfuqizohet neni përkatës që u jepte kompetencë këshillave bashkiakë të miratonin çdo muaj listën e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, si dhe për personat me aftësi të kufizuara. Në me dakordësi të gjithë bashkë në atë kohë, duke qenë se ministria ishte duke punuar për projektligjin “Për asistencën sociale” kërkuam të mos bënim arnime të herëpashershme të ligjit, por të bëhej një paketë e plotë dhe kjo gjë të adresohet në ligjin e ri që do të vinte. Sot më duhet ta pranoj me shumë kënaqësi se roli i këshillave bashkiakë të cilët duhet të mblidheshin një herë në muaj dhe të miratonin, noterizonin listën e personave formalisht, të cilët kishin të drejtë ta përfitonin, por nëse nuk merrni votën pro të këshillit bashkiak duhej të endeshin zyrrave të institucioneve deri sa ta përfitonin, nuk është më, sepse ky rol është aneksuar. Këshilli bashkiak nuk ka më asnjë kompetencë për ta miratuar këtë listë, por procedura duke

qenë se është thjeshtësuar, duke qenë se janë parashikuar qartë si përcaktohen kriteret, kushtet dhe kush i përcakton përfituesit, pra të gjitha garancitë janë dhënë në ligj, këshilli bashkiak është ankesuar në rolin e tij për këtë vendimmarrje dhe shqetësimi që zoti Sinaj ngriti për qytetarët e Selenicës, por në fakt është një shqetësim për të gjithë qytetarët e Shqipërisë që janë subjekte përfituese të këtij ligji, nuk do të jetë më.

Pjesa tjetër e abuzivitetit që bëhej me ndihmën nëpërmjet të gjitha hallkave të cilat duhet të kalonin qoftë edhe me miratime formale, listat përkatëse është evituar. Për sa kohë që institucionet i kanë të qarta detyrat, kushtet dhe kriteret përkatëse janë të përcaktuara qartë në ligj, duhet vetëm që kontrolli administrativ i atyre që punojnë, të jetë efektiv që të zbatohet ligji ashtu siç duhet dhe të mos vuajmë gjithmonë nga fakti që bëjmë ligje të mira, por nuk i zbatojmë siç duhet. Zbatimi i ligjit që të jetë efektiv duhet që kontrollin e tij ta ketë efektiv.

Po e mbyll dhe që të mos zgjatem, zoti kryetar jemi gati për diskutime, për pyetjet, përgjigjet, si dhe për diskutimin nen për nen të projektligjit.

**Ulsi Manja** - Shumë faleminderit, zonja Bushka!

Ka pyetje?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** - Përpara se të bëj pyetje, kam një vërejtje në formë sugjerimi, zoti kryetar ne sot diskutojmë 3 projektligje shumë të rëndësishme: “Për asistencën sociale”, “Për mbrojtjen civile” dhe “Për rininë”. Të tria projektligjet, me sa pashë sot, prekin funksionet e pushtetit vendor.

Zoti kryetar, të mos harrojmë se jemi një komision që kemi një nënkomision të posaçëm, që kam nderin ta drejtoj, pak rëndësi ka kjo me sa duket, për organet e pushtetit vendor. Pa pushtetin vendor asnjë nga këto projektligje nuk mund të realizohet. Edhe ky projektligj që sapo foli relator (kam respekt) edhe zëvendësministrja që u heqin disa nga funksionet. Kjo do të thotë, se vërtetë jemi një komision për dhënie mendimi, po do të donim që në mbledhjet që bëni për shpërndarjen e projektligjeve komisioni ynë të jetë i vlerësuar në sensin që ne të kemi mundësi të mbledhim Nënkomisionin e Posaçëm të Pushtetit Vendor, të mbledhim strukturat dhe shoqatat vendore, pasi ne duhet të dëgjojmë zërin e tyre, e kemi të shkruar në ligj, që duhet të dëgjohet mendimi i tyre, përpara se të vijojmë në diskutimin në komisionin tonë për të dhënë mendim. Pastaj kalon në komisionin përgjegjës. Por dhënia e përgjigjes nga ana e komisionit tonë ka të bëjë shumë. Nuk është thjesht kalimi i një projektligji që është në funksion dhe në përputhje me

Kushtetutën, me Rregulloren e Kuvendit. Nëse jemi dakord, e kalojmë në komisionin përgjegjës dhe ata kanë të drejtë të bëjnë disa ndryshime.

Zoti kryetar, kjo vërejtje që bëra ka të bëjë me ju, sepse ju e drejtoni këtë komision. Në komisionin tonë ka edhe nënkomisione të posaçme për të Drejtat e Njeriut, për Pushtetin Vendor, të cilat nuk janë ngritur kot. Nëse ju i quani të tilla, atëherë si anëtar i komisionit do të bëj disa pyetje. Kam shumë vërejtje edhe për dy projektligjet që do të vijnë më pas.

Pyetja ime është shumë korrekte dhe shumë dashamirëse, shmangia e këshillit të bashkisë thonë zëvendësministrja dhe relatorja si koncept burokratik. a është pengues, mendoj unë për këtë projektligj? Unë them se po. Po të lexojmë ligjin nr. 139 të vitit 2015 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor” që është votuar me tre të pestat, në nenin 24 thuhet: “Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale”, pra funksionet e bashkive në fushën e shërbimit social. Ka një nen të caktuar ku thuhet: “Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale në nivel vendor për shtresat në nevojë, për personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, për kryefamiljarët, për familjarët e dhunuar” e të tjera është funksion i pushtetit vendor. Ne tani çfarë bëjmë me ligj? Ia heqim këtë funksion pushtetit vendor. Pse, sepse në praktikë dhe unë jam plotësisht dakord me ju, ka ndodhur që disa këshilla bashkie të papërgjegjshme me vonesë të vullnetshme kanë bërë të mundur të mos jepet ndihma ekonomike një muaj apo dy muaj. Është edhe nisma e kolegut tonë Sinaj, që siç tha edhe relatorja e kishte paraqitur këtu. Por a lejohet një gjë e tillë? Çfarë po bëjnë me ligj? Këta, në nenin 21 thonë që këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikues, të cilat nuk janë shpallur në sistemin e pikëzimit. Pra, sistemin e pikëzimit e mbajnë vetë, në drejtorinë qendrore rajonale. Mbasi i pikëzojnë, thonë se këta dhjetë apo pesëmbëdhjetë familje në Lushnjë, që do të marrin ndihmë ekonomike. Pjesën tjetër, 6 % shtesë e këtij fondi, në mos gaboj, ia lënë si kopilin në derë, ia lënë topin në derë bashkisë. Me këtë 6-përqindësh ti mund të bësh çfarë të duash. Të thonë: na, po ta lëmë këtë 6-përqindësh, se këta të pikëzimit i bëjmë vetë, si drejtori rajonale. Me këtë 6-përqindësh që ngelet, merru ti si bashki! Për hir të së vërtetës e për shkak të eksperiencës që kam në lidhje me pushtetin vendor, por edhe si deputet, duke qenë shumë i lidhur edhe me zonën, sepse shkoj e bëj takime çdo javë, di që shumica e njerëzve, madje jo shumica, por të tërë në përgjithësi, kanë probleme. Me problemet që kanë, vijnë për takim me kryetarin e bashkisë, me administratën e bashkisë, me deputetin e zonës, që të kërkojnë ndihmë, ndërkohë që drejtorja është vetëm një hap më larg në dhënien e kësaj pike. Pse? Sepse drejtorja thotë: unë kam pikëzimin tim, të cilin ti vetë e ke

miratuar, zoti deputet, e ke miratuar vetë në parlament. Prandaj them ndonjëherë se duhet të tregojmë kujdes kur ngremë dorën, se na e kthejnë reston kështu pastaj: e ke miratuar vetë, ke ngritur një sistem pikëzimi, me vendim qeverie është ky sistem pikëzimi, këta marrin ndihmë ekonomike, nuk dua t'ia di për këtë tjetrin.

I thonë qytetarit: në qoftë se ti ke një frigorifer dhe një televizor në shtëpi, që përgjithësisht kanë të gjithë, ti nuk do të hysh në skemën e ndihmës ekonomike, nuk ke të drejtë të marrësh ndihmë. Po kush nuk ka një televizor e një frigorifer në shtëpi sot? Nuk po flas për televizor të fjalës së fundit, por të gjithë mund të kenë njerëz jashtë, e veç kësaj ka edhe njerëz bamirës që mund të ta dhurojnë. Edhe vetë ne kemi dhuruar. Tani ti i thua: nëse vi e të bëj kontroll në shtëpi dhe të gjej një frigorifer e një televizor, nuk do të marrësh ndihmë ekonomike.

Pra, unë mendoj se duhet të shikohet e të trajtohet pak më me qetësi, sa i takon rolit të këshillit bashkiak.

Shikoni, zonja relatores, sepse më pëlqeu shumë interpretimi juaj: te neni 22, pse ma keni kthyer organin e pushtetit vendor në një shtesë statistikore të drejtorisë rajonale të shërbimit social? Po të isha unë kryetar bashkie, nuk do ta zbatoja këtë nen këtu, sepse punonjësit e mi nuk janë shtesë statistikore për drejtorinë rajonale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sepse roli dhe struktura përgjegjëse e shërbimit social në bashki është: “dërgon regjistrin ekonomik elektronik kombëtar, përgatit listën për masën e përfitimit, harton kërkesën për buxhetin, grumbullon...”

Çfarë jam unë? Unë do të bëj materiale dhe statistika për drejtorinë rajonale të ministrisë? Jo, zonja, jo! Atë do ta bëj për veten time, por të kem mundësi dhe të ndihmoj, të kem mundësi të jap edhe ndihmë ekonomike, të kem mundësi edhe për fonde, që të bëj ndërhyrje. Ne themi: kompetenca, kompetenca për pushtetin vendor, por me ligje të veçanta mundohemi ta rrjepim dhe t'ia marrim kompetencat.

Unë protestoj, zoti kryetar! Protestoj për të gjithë projektligjet që kanë ardhur sot këtu. Do të flas edhe për dy projektligjet e tjera në parim dhe për nene të caktuara, që ju nuk i vlerësoni organet e pushtetit vendor, sidomos Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore këtu në parlamentin tonë. Do kohë më shumë që të diskutohet, të vijnë grupet e interesit, të gjejnë gjuhën e përbashkët, të paraqesin ligjin dhe nenin përkatës, dhe atëherë ne numd ta konsiderojmë të ezauruar saktë e drejt, duke miratuar një projektligj që e pëlqejnë të gjitha palët dhe që mund të realizohet. Mund

të ketë edhe funksione që duhet t'ia japim. Absolutisht që mund t'ia japim, por duke e shoqëruar me fondet përkatëse.

Të gjitha funksionet që ke sot në ligje, ia jep pushtetit vendor, por nuk i jep asnjë kokërr leku. Çfarë do të thotë kjo, kur e ke me ligj të posaçëm?

Unë këto dy pyetje kisha në lidhje me çështjen. Fola në parim për çështjen e ndihmës ekonomike, për nenin 21 dhe nenin 22: shmangia e këshillit të bashkisë si koncept burokratik, a për ligjet me këtë ligj që po bëjmë ne, dhe i lë vetëm 6-përqindëshin? Kaq! Pastaj do të diskutojmë.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit për pyetjet, zoti Fino!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, një sekondë! Ju lutem, zoti Shameti!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Shameti!

Përpara se t'ia fjalën zëvendësministres, për të dhënë përgjigje në lidhje me pyetjet e kolegut Fino, duke qenë se zoti Fino bëri një vërejtje për procedurë, po, është e vërtetë, zoti Fino, në Komisionin e Ligjeve është edhe Nënkomisioni për Pushtetin Vendor. Në fakt, në praktikë, ne i kemi kaluar projektligjet në Komisionin e Ligjeve edhe kur kanë pasur të bëjnë me pushtetin vendor, pa i kaluar te nënkomisioni përkatës, sepse anëtarët e atij nënkomisioni janë ndërkohë edhe anëtarë të Komisionit të Ligjeve.

Unë jam plotësisht dakord me metodikën e punës që do të duhet të ndjekë Komisioni i Ligjeve në të ardhmen. Edhe ju, si nënkryetar i Nënkomisionit për Pushtetin Vendor, në momentin që projektligji është shpërndarë të gjithë kolegëve deputetë nëpërmjet postës elektronike, mund të më kishit sugjeruar që ky projektligj të kalonte paraprakisht në nënkomisionin që ju drejtoni.

Gjithsesi, kjo mbetet një praktikë, e cila, në të ardhmen duhet pasur në vëmendjen e punës së komisionit, ndonëse mendoj se projektligji në fjalë, që kemi sot, mund të diskutohet si duhet dhe në masën e duhur, me qëllim që të gjitha problemet që ju ngrini të ezaurohen edhe në Komisionin e Ligjeve, sepse anëtarët e nënkomisionit janë prezentë këtu.

Zonja Kospiri, fjala për ju, që t'u jepni përgjigje pyetjeve të kolegut Fino.

**Bardhylka Kospiri** – Faleminderit, zoti kryetar!

**Ulsi Manja** – Do t'ju lutesha që përgjigjet t'i jepnit në mënyrë të përmbledhur.

**Bardhylka Kospiri** – Për efekt kohe, atë fundin e prezantimit e reduktova pak, ndaj do të doja t'ju bëja me dije se përveç të tjerave, ky projektligj ka kaluar për diskutime dhe në dy

mbledhjet e këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore gjatë muajve dhjetor 2018 dhe prill 2019.

Përmes këtyre takimeve u bë e mundur që të merreshin mendimet e 30 bashkive të vendit, pasi në 31 bashki është rënë dakord apo nuk kanë sjellë mendime. Mbi 30 % e komenteve të mbledhura nga konsultimet u reflektuan në përmbajtjen e projektligjit, ndërsa në lidhje me sugjerimet e paflektuara janë dhënë argumentet përkatëse. Kjo ishte një nga pikat që desha të bëja me dije.

E dyta ka të bëjë me nevojën për t'iu hequr kjo kompetencë njësive të pushtetit vendor. Unë mund t'ju them se sot bashkia Selenicë, ku deputeti e ka ngritur si problem, ende nuk e ka mbledhur këshillin për të dhënë pagesat e qershorit, ndërkohë që detyrimi ligjor është për datën 20 të muajit, kur bëhet mbledhja e këshillit bashkiak, por nga statistikat tona na rezulton se vetëm 20 % e bashkive e respektojnë datën 20 të çdo muaji për të mbledhur këshillat e tyre.

Në këto kushte, me ankesat pa fund që vijnë edhe nga grupet e interesit, të cilët gjithmonë marrin në telefon apo komunikojnë në forma të ndryshme me ministrinë, ky është një nga problemet më të mëdha, për shkak të të cilit ata mbeten jo një ditë, por një javë e më shumë pa marrë pagesat., ndërkohë që na sjellin shqetësimet e tyre: jemi pa mbështetje financiare në lidhje me mjekimet e të tjera me radhë.

Tjetër gjë që doja të theksoja, e që e kemi përmendur disa herë në mbledhjet e më pashme. Së pari, lidhur me formulën e pikëzuar, unë e theksova se do të zgjidhet me një VKM më të detajuar e më të qartë, por fakti është ky: as televizori e as frigoriferi nuk janë më pjesë e variablave që llogariten në formulë. Së dyti, janë një tërësi variablash ato që përcaktojnë “Po”-në apo “JO”-në e të qenit përfitues i ndihmës ekonomike. Pra, nuk mjafton vetëm një variabël: ka këtë ose s'ka këtë, arsye për të cilën bëhet apo s'bëhet përfitues, po për të qenë të hapur, për të qenë sa më shumë transparent, kjo pjesë do të saktësohet me një VKM, në mbështetje të këtij ligji.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Kospiri!

Zoti Fino, ke pyetje të tjera?

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar, faleminderit për sqarimin që dhatë! Kur ju drejtova juve, thashë se ju e keni të drejtën e organizimit të këtij komisioni, dhe në varësinë tuaj janë edhe nënkomisionet. Kjo nuk do të thotë se nuk mbaj përgjegjësi edhe unë në lidhje me mosbërjen e mbledhjeve të nënkomisionit, por gjithsesi, është çështja juaj kur trajtoni në byronë parlamentare



ligje të cilat kanë problematikë me pushtetin vendor. Absolutisht që duhet të jenë prezente këtu, nuk them që ky të jetë komision përgjegjës, por duhet të diskutohen.

Ligji “Për vetëqeverisjen vendore” është edhe me tre të pestat, i kaluar në 2015-ën, ligji 139, ligj shumë i rëndësishëm, sepse e ka votuar i gjithë parlamenti. Të gjitha ligjet e tjera që bëjmë, janë në funksion të tij. Asnjë nga këto ligje nuk prevalon mbi ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, sepse ai është një ligj i cilësuar, me 84 vota. Kjo do të thotë se, në qoftë se një këshill bashkiak nuk punon, ligji ka sanksione. Këshilli bashkiak shpërndahet. Po s’e bëri punën, merr masa prefekti. Janë të shënuara të gjitha në ligj. S’kemi lënë presje pa vënë aty. I kemi trajtuar të gjitha. Merr masa prefekti, ministri i Brendshëm, që e ka në varësi, dhe e shpërndan atë këshill. Pastaj, brenda muajit bëhet mbledhja për të votuar këshillin e ri, i cili e ka si detyrë ta miratojë atë listë.

Në qoftë se ka një këshill bashkiak është i kundërligjshëm dhe nuk vepron, nuk mund të bëjmë ndryshim të ligjit, duke i hequr pushtetin vendor një kompetencë reale. E gjithë kjo, thjesht pse këshilli bashkiak i Selenicës nuk zbaton ndarjen e ndihmës ekonomike. Nëse 99 e ca për qind e këshillave janë korrekte, për një këshill që s’bën detyrën, ne e përcaktojmë në ligj se duhet ta bëjë drejtoria rajonale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Tregova shumë respekt për ju, kur folët, dhe nuk ju ndërhyra asnjëherë. Unë ju dëgjoj me shumë vëmendje.

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, mund të vazhdoni!

**Bashkim Fino** – Jam shumë **enigmatrak** në aspektin juridik, në raport me ju, zonja Bushka! Jam shumë **enigmatrak**, të them të drejtën. Nuk jam jurist, kam një jetë këtu në parlament, por nuk jam dot në lartësinë tuaj, se ju jeni juriste, jeni që të gjithë në përgjegjësi, ndaj nuk ndërhyra, por ju dëgjova me shumë kënaqësi. të lutem, në flas për fushën time, për një ligj që e kam bërë vetë, do të ishte e pakuptimtë ndërhyrja nga ana juaj. Megjithatë, ju e mendoni ashtu, ndërsa unë kështu. Kemi të drejtë të mendojmë secili sipas konceptit që ka.

Ju mendoni se duhet t’ia heqim një kompetencë, ndërsa unë mendoj se jo. E thashë edhe një herë: ligji që kemi bërë është me tre të pestat, është më i fuqishëm se ky ligj që po bëjmë. Nëse doni t’ia hiqni këtë kompetencë, hiqjani, por unë po ju them: në ligjin ekzistues që kemi, “Për

vetëqeverisjen vendore” ka kompetenca, ka sanksione për çdo këshill që nuk vepron. Në qoftë se ne i zbatojmë të gjitha sanksionet, të jeni të bindur se edhe ata do ta bënin punën. Në qoftë se ata nuk bëjnë punën dhe ne ndërhyjmë në ligjin përkatës duke bërë ndryshime, kjo nuk më duket korrekte. Më takon ta mbroj atë ligj, të cilin e kemi votuar të gjithë me konsensus të plotë, dhe më vjen mirë që e kemi votuar ashtu.

Në rastin konkret s’kam komente të tjera.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Bushka ka kërkuar fjalën.

**Klotilda Bushka** – Unë jam absolutisht dakord me zotin Fino, nëse me projektligjin për asistencën sociale prekim ligjin për pushtetin lokal, i biem ndesh dhe ky projektligj nuk duhet të kalojë në nenin ku ka kundërshti. Ne nuk jemi në këtë situatë, sepse sipas ligjit për pushtetin lokal kompetencat që kanë këshillat bashkiakë, të cilat janë të parashikuara dhe të miratuara me një ligj me 3/5-at, prevalojnë mbi çdo lloj parashikimi të natyrës së ngjashme apo të njëjtë me këtë që ne po parashikojmë sot. Këto kompetenca nuk ngjajnë me këto që parashikon ky projektakt. Pse? Sepse e drejta e këshillit bashkiak për të miratuar si noter listat e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuara, nuk është e parashikuar në ligjin për pushtetin lokal, por në ligjin për shërbimet dhe ndihmë shoqërore dhe ka mbetur që në vitin 2005.

Nëse u hyjmë kompetencave të këshillave bashkiake, kjo nuk është një nga ato kompetencat thelbësore, pa të cilën këshilli bashkiak nuk e ezauron kompetencën e tij funksionale dhe ne po e cenokemi me një vendim. Pra, ka ngelur për efekt të skemave të vjetra në një ligj tjetër, i cili ka qenë i miratuar me shumicë të thjeshtë dhe po ndryshon sot për dy arsye.

Së pari, sepse nuk ka të bëjë me dhënien e shërbimeve sociale. Dhënia e shërbimeve sociale, menaxhimi i shërbimeve, planifikimi, është tashmë një shërbim që mbetet në kompetencën e organeve të vetëqeverisjes vendore, të cilat, sigurisht, vendimmarrjen dhe menaxhimin e kanë parashikuar qartë në ligjin e vet, ku këshilli bashkiak i ka të qarta kompetencat. Kompetenca e miratimit të listave të personave, që përfitojnë si noterë, ka qenë te ligji që po shfuqizohet sot, por jo te ligji i pushtetit lokal. Pra, nuk ka një ndërveprim dhe një kundërshti midis asaj që parashikon ligji për pushtetin vendor, me ligjin që shfuqizohet me hyrjen në fuqi të projektaktit.

Arsyeja e dytë është se vetë këshillat e kanë kërkuar në konsultimet publike. Kjo është një kompetencë ku në thelb ata nuk ushtrojnë ndonjë të drejtë dhe nuk u japin ndonjë vlerë të shtuar

shërbimeve. Ata thjesht bëhen bllokues, siç është rasti i bashkisë së Selenicës. Nuk është problemi që kjo ka ndodhur vetëm në disa bashki. Jo çdo muaj këshillat mblidhen domosdoshmërisht, ndërkohë që ndihma ekonomike duhet të miratohet çdo muaj. Edhe kur e kanë bërë disa bashki, që kanë qenë më të ndërgjegjshme, me vendim qarkullues, përsëri nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me ligjin, sepse vendimet qarkulluese nuk njihen në mënyrë të plotë të ligji për vetëqeverisjen vendore. Prandaj, gjithçka bëhet për ta vënë edhe në pozita ligjshmërie të sakta këtë lloj vendimmarrjeje, por edhe që për efekt të këtyre burokracive të mos bllokohet dhënia e ndihmës për kategoritë në nevojë.

Unë do t'i jap 100% të drejtë zotit Fino, i cili është gjithmonë i saktë në arsyetimet që bën, por situata këtu është ndryshe. Pra, nuk është *mot a mot* ky rast.

A do të ishte e udhës t'i konsultonim me nënkomisionin e posaçëm të pushtetit lokal? Pa diskutim që po, por nëse i referohemi tabelës së konsultimit publik që ka projektakti, të gjitha bashkitë e kanë dhënë mendimin e tyre dhe, me sa shoh nga statistika, pothuajse të gjitha kanë qenë dakord me këtë parashikim, sepse këto lloj ndihmash që jepen sot, këto lloj asistencash, që janë shpërblime në para, janë të gjitha të financuara 100% nga buxheti i shtetit, për të evituar që gabimet e mundshme të lënë jashtë skemës së ndihmës ekonomike familje që nuk mund ta kenë përfituar për efekt të atyre variablave, që nuk e kapin spektrin e gjerë.

Sipas nenit 21 të projektit aktual, roli i këshillit bashkiak, është lënë që një përqindje të caktuar, po nga buxheti i shtetit, ta menaxhojnë vetë sipas kushteve dhe kriterëve, që janë të ndryshme në qytete të ndryshme. Pikërisht për këtë arsye hyjnë në punë shërbimet sociale të bashkive, që, për kategori të ndryshme në qytetet e tyre kanë administratorët socialë, të cilët thonë se kemi një targetgrup të caktuar njerëzish, që nuk kanë mundur të hyjnë, edhe pse përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, dhe i propozojnë këshillit bashkiak të miratojë disa kushte dhe kriterë të veçanta për këtë kategori, pa i rënë ndesh skemës kombëtare. Nëse këto familje, që janë vërtet në nevojë, nuk përfitojnë dot nga skema kombëtare, që, siç e thashë dhe po e përsëris, financohet e gjitha nga buxheti i shtetit, u lihet mundësia këshillave bashkiakë që një përqindje të caktuar t'ia lënë këtij grupi të veçantë. Vetëm këtu hyn roli i këshillit bashkiak, si një kompetencë e shtuar në projektaktin që jemi duke diskutuar. Të gjitha detyrat e tjera për shërbimet sociale i kanë në ligjin për vetëqeverisjen vendore.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Fino ka një replikë dhe pastaj do të ketë pyetje nga kolegët e tjerë...

**Bashkim Fino** – Nuk e kam në sensin e replikës...

**Ulsi Manja** – Ju lutem, nëse doni, e votojmë në parim sot dhe e shtyjmë për në shtator! Për mua nuk ka ndonjë problem.

**Bashkim Fino** – Unë kam të drejtë ta them këtë, pastaj votojeni dhe bëni çfarë të doni. U shpreha gabim, se nuk kam të drejtë replike, por kam të drejtë t'i kthej një përgjigje koleges sime Bushka. E thashë edhe një herë, unë nuk mund të hyjë dot në diskutim juridik me të, sepse kjo është betejë e fituar nga ajo, jo nga unë, por nga unë është fituar diçka tjetër, zonja Bushka.

Më lejoni t'ju them se te ligji nr.139 i viti 2015 (ju besoj se e njihni mirë atë ligj, por rishikojeni edhe një herë), kreu VII, janë funksionet dhe kompetencat e njësisë së qeverisjes vendore.

Çfarë është ky kreu? Ky kreu jep parimet themelore të kompetencave të organeve të pushtetit vendor dhe ka disa lloj funksionesh: ka parimet e ushtrimit të funksioneve; funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës së shërbimeve; funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale; funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve të argëtimit; funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit; funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve, kullotave, natyrës dhe biodiversitetit; funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor; funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike dhe arrin kulmin te funksionet dhe kompetencat e deleguara.

Në të gjitha këto funksione që përmenda (nuk dua t'i lexoj tani) janë parimet kryesore. Kjo do të thotë se edhe neni 24, të cilit iu referova, funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale, thotë: “Krijimi, administrimi i shërbimit social në nivelin vendor për shtresat në nevojë, personat...sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

Ju sapo më thatë që ligji i kaluar paska qenë më demokratik, më i decentralizuar, në raport me këtë projektligj sot.

Pra, ligji me 3/5-at thotë se bashkia do të ketë këtë gjë në funksion të ligjit. Ai ligj ia kishte lënë të hapur, ia kishte lënë bashkisë.

Ju sot na sillni një ligj që mbështetet në ligjin për pushtetin vendor, se i ka këto funksione, por ia hiqni këtë kompetencë dhe i thoni: “Këto para nuk do t'i përdorësh ti, si bashki, por do t'i përdorë zyra rajonale qendrore për të ndarë fondet e ndihmës ekonomike.” Madje, e ngatërroni

bashkinë dhe i thoni: “Mbaje një 6-përqindësh në bazë të pikëzimit që bëjmë ne, pra zihuni me ata të tjerët.”

Çfarë ndodh në praktikë, zonja Bushka? Tashmë, ti je deputete e vjetër dhe e di se çfarë ndodh në praktikë. Në praktikë ndodh problemi, që, atij që nuk fiton ndihmë ekonomike, drejtorja qendrore i thotë: “Shko, se e ka bashkia mundësinë të të japë lekë, se ka një 6-përqindësh! Shko, se ti nuk e plotëson kriterin e pikëzimit tek unë! Mos eja më tek unë!” Kjo nuk është për t’ia lënë topin në derë bashkisë. Bashkia ka plot halle e probleme, sa të duash!

T’i thuash pjesës tjetër: “Shko atje, se ta zgjidh ai, se me mua nuk e fiton dot nga pikëzimi, se ata kanë një 6-prqindësh dhe mund ta japin...”, nuk më duket korrekte. Këtë jam duke thënë.

Meqenëse këto janë fonde të buxhetit të shtetit dhe do t’i bëjë shteti, le t’i bëjë. Atëherë, bashkia bën një gabim shumë të madh që ngre në strukturën e saj administratorë socialë. Të mos ketë fare administratorë socialë, në qoftë se shteti ia merr të gjitha fondet, i ka vetë, i shpërndan vetë...

Por të ketë një administrator social, që thjesht të bëjë një statistikë për zyrën rajonale, kjo më duket jokorrekte. Se kështu thoni ju: “Këto janë fonde të buxhetit të shtetit”. Çfarë rëndësie ka kjo?! Kjo nuk ka fare rëndësi, rëndësi ka që organet e pushtetit vendor duhet...

E fundit, që të jeni edhe ju shumë të qetë dhe të qartë, unë nuk do të dyshoj nëse këta kanë bërë konsultim me mbështetjen e bashkive.

Sapo dolëm nga zgjedhjet dhe kemi një konfigurim të ri, kemi kryetar të rinj, kemi këshilla të rinj, të cilët, për hir të së vërtetës...

Në rregull, se është një proces.

Për hir të së vërtetës, po ndryshojmë tri projektligje në momentin kur kemi një javë që kemi mbaruar zgjedhjet lokale. Mbase do të ishte mirë që, edhe kryetarët e sotëm të bashkive, që do të kenë mandatin për 4 vjet, edhe këshillat e sotëm bashkiakë, t’i rishikojnë këto projektligje. Në qoftë se ti (nuk e kam për ty, por për ministrinë) e ke bërë konsultimin me këshillat e vjetër, me kryetarët e të tjerë, dakord, por pse, kur kemi mundësinë të marrim dhe mendimin e kryetarëve të rinj, që sapo e filluan mandatin për 4 vjet?

Faleminderit shumë!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Hyseni e ka kërkuar fjalën për pyetje.

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një shqetësim dhe ndoshta relatorja mund të na japë ndonjë mendim.

Kam hasur shqetësimin e dhjetëra njerëzve, për të mos thënë më shumë, së paku nga ata që kanë kontaktuar zyrën time, për çështjet që përfshihen edhe te ky ligj, pra përfitimi i ndihmës ekonomike, që njerëzit, siç e tha edhe relatorja, kanë pasur ecejake të vazhdueshme.

Çështja është: a e zgjidhim ne me këto formulime, që, nga ajo që lexoj unë, janë të komplikuar për t'i kuptuar edhe deputetët e jo më për njerëzit e thjeshtë?

Ky ligj, së paku, duhet të jetë i kuptueshëm për njerëzit e thjeshtë.

Si mund ta kuptojnë njerëzit e thjeshtë një formulim të tillë: “Formula e unifikuar e pikëzimit, një formulë e pranueshmërisë së familjeve për ndihmë ekonomike, që përdor koeficiente dhe ndryshore të përcaktuara qartë, të cilat dalin nga lidhjet reciproke objektive me statusin ekonomik dhe më varfëri”?

Unë mund t'ju them se ndryshoret në konceptin matematik nuk janë të përcaktuara, që ta marrin vesh edhe këta propozuesit. Tani, të thuash edhe “ndryshore”, edhe “të përcaktuara”, nga pikëpamja matematike është gabim shumë i rëndë!

Së dyti, më shqetëson fakti që ndihma sociale nuk është matematikë, por humanizëm. Humanizmi nuk përcaktohet me formulë. Unë e kuptoj që ka pasur abuzime pa fund, e kuptoj edhe që ka mekanizma partnerë, të cilët kanë sugjeruar që të gjendet një formulë, por duhet t'i lëmë hapësirë më të madh pushtetit lokal dhe unë mendoj se tani është momenti, sepse po nuk e bëjmë sot nuk e bëjmë dot më. Ne jemi qeveri socialiste, humane, jemi për ata njerëz më shumë se për kategoritë e tjera, kështu që ta bëjmë mirë këtë ligj, zoti kryetar, se, në gjykimin tim, ka vërtet probleme. Nuk e di si e gjykon relatorja, se ne jemi komision për dhënie mendimi, por nuk mund të ecë kështu ky ligj, nuk mund të futen aty formula unike, duhet të ishte në VKM, pasi në ligj futen vetëm emërtimi dhe metodologjia dhe përcaktohet me VKM.

Herë pas here qeveria përcakton formula të ndryshme, kriteret janë në ligj dhe nuk janë keq, por formula nuk përcaktohet fare në ligj për mua. “Formulë pikëzimi” është *nonsens*, nuk shkon fare me termin human që kërkon të mbulojë ky ligj. Unë mendoj se nuk do të ishte keq propozimi që bëtë ju, duke marrë parasysh edhe vërejtjet e zotit Fino, që, nëse nuk është domosdoshmëri për ta kaluar tani, ta kalojmë në parim, se është ligj i rëndësishëm, por t'i japim kohë komisionit dhe komisioneve të tjera, që ta diskutojnë më konkretisht për ta përmirësuar.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Do të kemi një përgjigje edhe nga zëvendësministrja për shqetësimet që ngritën kolegët deputetë. Po të mos ishte ky ligj i rëndësishëm për ta kaluar brenda këtij sesioni parlamentar, qeveria mund ta kishte sillte në shtator. Fakti që të tria këto projektligje, sidomos ligji që po diskutojmë dhe ligji i mbrojtjes civile në Konferencën e Kryetarëve, janë lënë të kalojnë në seancën e datës 18 korrik, ndryshe nga projektligji “Për rininë”, do të thotë se propozuesi, pra Këshilli i Ministrave, ka urgjencat e tij. Gjithsesi, nëse do të duhet kohë në interes të projektligjit, do ta japim kur të diskutojmë nen për nen. Ky projektligj duhet të kalojë në seancën e datës 18 korrik, që është seanca e fundit për këtë sesion parlamentar.

Zonja Kospiri, ju lutem një përgjigje shumë shkurt për pyetjen e kolegut Hyseni lidhur me formulën e pikëzimit. Më pas e ka kërkuar fjalën zonja Hysi.

**Bardhylka Kospiri** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e theksova edhe gjatë fjalës sime që do të ketë një VKM të veçantë, e cila do të detajojë variablat brenda skemës së llogaritjes. Siç e thashë, nuk duhet të kapemi thjesht pas një ndryshimi, pasi, mbi bazë shkencore është ndërtuar mënyra e llogaritjes të të gjitha variablave për të na çuar në përfitues apo jo të skemës së ndihmës ekonomike.

Në vijim do të doja të theksoja diçka në lidhje me kompetencat e pushtetit vendor për sa u përket shërbimeve sociale. Tashmë ne kemi një ligj të ri të shërbimeve sociale të miratuar në vitin 2016. Nëse do t'i kthehemi historikut, nga ligji i vjetër nr. 9355 i vitit 2005 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale” u shkëput ligji i parë dhe u nxor një ligj i ri “Për shërbimet sociale”, ku, në përputhje me të gjithë legjisllacionin e pushtetit vendor, i lë kompetenca të plota pushtetit vendor, sepse pushteti vendor është më pranë nevojave të njerëzve. Ajo do të ketë një strukturë brenda bashkive apo njësisive të pushtetit vendor (madje në disa vende është ngritur), që vlerëson nevojat dhe referojnë rastet. Ky është roli i pushtetit vendor dhe për të realizuar këtë mbështetje në shërbim të qytetarëve brenda bashkive është ngritur fondi social, i cili është detyrim dhe kompetencë e pushtetit vendor për ta ngritur, ku bashkëveprojnë pushteti vendor me atë qendror dhe burime të tjera. Këtë na kërkojnë vazhdimisht përfituesit.

Për sa u përket pagesave në para të ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar, janë pagesa që kalojnë direkt nga buxheti i shtetit dhe Këshilli, në funksion e fundit të tij, thjesht kalon listat e aplikuesve, nuk ka pasur asnjë ndërhyrje, vetëm se na vonon në kohë dhe kjo është pjesa që na detyroi dhe ishin përfituesit dhe kërkuesit që bënë që të ndikonte sa më shpejt.

Po ju them edhe që janë shumë të interesuar që të ndodhë sa më shpejt, madje marrin në telefon për të pyetur a e kaluam apo jo ligjin.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Kospiri!

Zonja Hysi ka pyetje.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Kospiri!

Gjithashtu falënderoj dhe zonjën Bushka për prezantimin!

Unë kam disa pyetje që lidhen me shqetësimet, që na adresojnë shpesh qytetarët për këtë çështje.

E para, a adreson ky projektligj shqetësimet që kanë ngritur familjet që kanë fëmijë autikë dhe me sindromën *down*? A janë ata përfitues?

E dyta, ju thoni se asistencë sociale përfshin ndihmën ekonomike, pagesën e aftësisë së kufizuar, ndihmën e menjëhershme financiare, pra çekun e bebeve, por nuk kufizohet vetëm në to. Çfarë ofrohet tjetër nga kjo asistencë sociale, se ia vlen të bëhet e qartë kjo gjë?

Lidhur me ndihmësin personal, ka pasur një diskutim, por ka dhe një sërë shqetësimesh të adresuara nga persona që kanë nevojë për ndihmësin personal. Kur ju thoni se ndihmësi personal është individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara, mendohet se do të jetë gjithmonë një person jashtë familjes, apo mund të jetë edhe një pjesëtar i familjes? Nëse duhet të jetë një infermier apo një person i specializuar, ky shërbim do të ofrohet 24 orë në 24 në rastet kur kërkohet, apo do të jetë me periudha të caktuara?

E bëj këtë pyetje pasi kam marrë një ankesë nga një kategori personash lidhur me këtë shqetësim.

Pyetja tjetër ka të bëjë me pagesat e aftësisë së kufizuar. Ju thoni që kërkesën për pagesën e aftësisë së kufizuar e bën personi. Ndërkohë, në ligj ka një ndryshim, ku thuhet se pagesa ndërpritet pas 24 muajsh, kurse ju e rrisni duke e bërë pas 48 muajsh, kur personi punësohet. Cila është praktika e vendeve të tjera dhe mbi ç'kritere është përcaktuar periudha 48-muaj nga momenti i punësimit? Nëse nuk jepet kjo pagesë, çfarë shërbimesh do t'i ofrohen personit pas 48 muajsh? Pra, nuk do të marrë pagesën e aftësisë së kufizuar, por ai vazhdon të jetë me aftësi të kufizuar.

Po marrë shkas nga ankesat që janë marrë, por e shoh që është adresuar edhe në ligj. Ju thoni që përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore ose 1-vjeçare, në varësi të fakteve, persona që nuk deklarojnë ndryshimin e situatës sociale-ekonomike çdo 3



muaj. Në vlerësimin tuaj, a ka kosto kjo për personin, se kjo bëhet pranë administratorit shoqëror? Si do të bëhet në ato raste kur personi ka lindur me aftësi të kufizuara, pra nuk është bërë i tillë? A duhet që të deklarojë vazhdimisht ndryshimin e situatës? Këtu kam parasysh kur flisni për nevojën e bërjes së ekzaminimeve çdo një vit dhe në rast se personi nuk paraqitet te komisioni 2 herë radhazi, ose refuzon mjekimin e kërkuar, atij i refuzohet përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar.

Rastet janë të tilla: kur një personi sot, dhe po flas për raste konkrete, zonja Kospiri, i cili nuk është në gjendje të lëvizë, jeton në katin e 12 të një pallati (kemi dy raste në Kashar), i thuhet se duhet të paraqitet menjëherë në QSUT, në momentin që ai është në krevat, nuk zbrit dot dhe detyrohen 4 veta të zbresin 12 shkallë se nuk kanë as ashensor, a është e nevojshme që të paraqiten? A shihni ndonjë lehtësi që komisioni epror të shkojë aty pranë?

E fundit që kam ka të bëjë me tërheqjen e pensionit. Ju thoni që pensioni tërhiqet në bankë ose me shërbim postar dhe kjo vendoset nëpërmjet vendimit që ka marrë komisioni. Komisioni është ai që do të bëjë vlerësimin se si do të merret apo nuk e keni të qartë?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Kush do t'ju përgjigjet pyetjeve të zonjës Hysi, por shumë shkurt, ju lutem?

**Bardhylka Kospiri** – Faleminderit, për pyetjet!

Janë një set pyetjesh, unë do të përgjigjem për disa, kurse për të tjerat do të përgjigjen koleget e mia.

Po e filloj me pyetjen e parë me rastet e fëmijëve autikë dhe ata me sindromën *down*, që janë disa nga kategoritë e aftësisë së kufizuar. Është e vërtetë që situata aktuale në të gjithë Shqipërinë ka qenë e tillë prandaj u ndërмор reforma, me qëllim që të ndryshonte mënyra dhe kriteret e vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Disa nga diagnozat kanë qenë të përjashtuara nga kriteret e vjetra të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Sot kemi dy manuale të reja të vlerësimit të aftësive të kufizuara të punuar nga mjekët më të mirë që kemi këtu në përputhje me kriteret e OBSH-së dhe të krahasimit ndërkombëtar të funksioneve. Këto grupime, që kanë qenë pjesërisht përfituese, sot janë plotësisht përfituese, pra futen në sistemin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Lidhur me ndihmësin personal, përsëri sot, në kushtet që jemi, personi (përfiton apo jo), vendoset në KMCAP-në që funksionon sot, për të parë nëse përfiton ose jo ndihmës personal. Me reformën ne shkojmë më tej, pra vlerësohet se për çfarë do të jetë ky ndihmës personal dhe jemi në hartimin e një akti nënligjor, pra të një VKM-je, si detyrim edhe i një ligji të mëparshëm të

përfshirë dhe aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara. Besoj se deri në fund të vitit ne do të nxjerrim VKM-në me specifikat e ndihmësimit personal. Rolin e ndihmësimit personal e kemi të përfshirë në ligjin për përfshirjen e aksesueshmërisë dhe në VKM-në “Për zbatimin e ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”, por në VKM që po përgatisim do të përcaktohen dhe ndahen edhe afati kohor i ndihmësimit personal dhe kategoritë që e përfitojnë. Pra, siç e kemi bërë me dije edhe në politikat e hartuara nuk do të ketë një vlerësim të njëjtë për të gjithë njerëzit me aftësi të kufizuara, por do të ndahet në bazë të funksionit dhe dëmtimit me katër shkallë vlerësimi, si: të thelluar, të rëndë, të moderuar dhe të lehtë.

Ajo që është thelbësore në reformën e vlerësimit është fakti që personat që duan dhe mund të punojnë do të mbështeten të shkojnë te formimi profesional i punësimit.

Komisioni i ri, që është ngritur, do të bëjë intervista personale për të bërë vlerësimin rast pas rasti, sipas nevojave personale të secilit. Pra, nuk themi më që personat janë paraplegjikë apo tetraplegjikë, por personat kanë këtë shkallë dëmtimi dhe do të përfitojnë 1,2,3,4 shërbime të përcaktuara.

Lidhur me pagesën e aftësisë së kufizuar pas 48 muajsh punësimi, dua të kthehem pak në retrospektivë. Ligji i mëparshëm nr. 9355 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale” ka pasur një nen që thoshte: “Personat me aftësi të kufizuara në momentin e punësimit të tyre humbasin të drejtën e pagesës”.

Në vitin 2014, kur filluam reformën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, u gjykua që kjo të rishikohet, sepse nuk kishte sens të ndodhte kështu dhe asnjë person me aftësi të kufizuara duke u takuar grupeve vulnerabël, edhe nga eksperiencia ndërkombëtare të sjellë te ne, nuk mund të punësohet në mënyrë të drejtpërdrejtë pa kaluar fazën e përgatitjes, këshillimit e të tjera. Në këto kushte, sa të plotësohej korniza ligjore edhe me reformën e aftësive të kufizuara, ne vendosëm që pagesa të zgjatej me dy vjet pas punësimit. Më pas, meqenëse reforma ishte në proces, ky afat u bë 4 vjet, por ne përsëri themi: vetëm kur të kemi shërbime të ofruara, pra personi të mos marrë vetëm lekë, të cilat, fatkeqësisht, në disa raste i shkojnë familjes për ushqim dhe gjëra të tjera, pra nuk i shkojnë direkt personit me aftësi të kufizuara.

Ne paralelisht po punojmë për ngritjen e shërbimeve që janë pjesë e kësaj pakete në kuadër të mbështetjes me fondin social. Në këto kushte personi me aftësi të kufizuara në 48 muaj i jepet mundësi që të shikojë qasjen e tij me vendin e punës dhe punëdhënësi të mësohet me këtë person.

Ajo që mund të jetë e diskutueshme është fakti kur personat me aftësi të kufizuara për momentin... Nuk po flas për skemën e pilotimit, sepse aty po përmirësojmë shumë gjëra, në pjesën tjetër të Shqipërisë janë ende të diferencuar në atë që përfitojnë, pra ndryshe përfiton grupi i të verbërve, ndryshe paraplegjikët dhe ndryshe grupi tjetër i personave me aftësi të kufizuara. Këtë ne po mundohemi ta sheshojmë dhe t'i vendosim në një stad të barabartë përfitimi të lidhur me dëmtimin dhe funksionin që ata kanë për t'i përdor. Ky është i gjithë thelbi.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Kospiri!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka pyetje të tjera pa përgjigje?

**Miranda Pasha** – Lidhur me përjashtimin, nëse për periudhën 6 mujore familjet nuk paraqiten për deklaratat 3-mujore, në fakt është specifikuar: “Në rast se nuk paraqiten apo nuk deklarohen këto ndryshime, këto familje do të përjashtohen nga ky përfitim”, kur ka ndodhur ndonjë fatkeqësi natyrore, për arsye shëndetësore, si dhe kur kanë anëtarë në familje që janë të deklaruar si invalidë pune, me aftësi të kufizuara apo me pamundësi lëvizje, është marrë parasysh që familja të mos penalizohet.

Problemi është se në reformën e re të ndihmës ekonomike deklarimi 3-mujor është një kusht lehtësimi pasi me skemën e vjetër deklarimi ka qenë i detyruar të bëhet për çdo muaj pranë administratorit të sigurimeve shoqërore. Kjo kishte një kosto shumë të madhe, prandaj me reformën e re detyrimi i paraqitjes është bërë një herë në 3 muaj.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është edhe një pyetje pa përgjigje.

**Bardhylka Kospiri** – Lidhur me periodicitetin e paraqitjes në kemp, në sistemin e vjetër detyrimi me paraqitje ka qenë sipas rregullores që ka pasur kempit, pra kishte me 6 muaj dhe me 1 vit, por me rregullin që ndodhi në vitin 2018 u mundësua që të mos paraqiten personat, por të paraqiten vetëm dosjet e tyre pranë komisioneve.

Ndërsa te reforma që po bëhet, si detyrim është vetëm paraqitja e parë përpara ekipit të vlerësimit, kur janë raste të reja, dhe të tjerët për të ruajtur një kontroll të shëndetit të mirë, e para.

E dyta, për të parë se si ka evoluar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe reforma është e lidhur me pjesën e ridaljes në komision, pra duhet vetëm paraqitja e parë, kur është një rast i ri. Por, nëse personi nuk mund të shkojë, atëherë shkon komisioni pranë tij me të gjitha mjetet lehtësuese për të ndërtuar një tablo për gjendjen e tij shëndetësore.

Është e drejtë ndërhyrja që bëri zonja Hysi. Në kuadër të situatës së përgjithshme që kemi sot në Shqipëri, ne po përpiqemi të kryejmë një akses të mundshëm për të gjithë qytetarët, pra jo vetëm për personat me aftësi të kufizuar, sepse kemi edhe të moshuar që mezi zbresin nga katet e ndërtesave pa ashensor. Pra ne po punojmë edhe në këtë drejtim, së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës kemi ndërtuar një plan aksioni dyvjeçar, që të arrijmë në disa përmirësime.

Por rastet e personave me aftësi të kufizuar janë vërtet shqetësuese, sidomos për ata që nuk lëvizin dot dhe në situata të tilla ekipet tona të urgjencave mundohen të bëjnë të pamundurën. Me kushtet që janë sot, kur nuk ka ashensor, duhen bërë lehtësira maksimale në mënyrë që shërbimi t'i shkojë atje ku duhet, pra ai person që nuk lëviz, i shkon komisioni në familje dhe kjo është e vendosur në ligj dhe do të zbatohet.

Ne kemi shumë raste të tilla dhe po mundohemi të bëjmë maksimalen edhe në bashkëpunim me gjitha bashkitë, në kuadër të pushtetit të ri vendor, pra të bëjmë të pamundurën që këta njerëz të lehtësohen në shërbimin e tyre. Gjithashtu, të krijohen lehtësira edhe në strehim, që e kemi te ligji për strehimin social...

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Kospiri!

Zonja Kospiri, edhe sikur të mos jesh person me aftësi të veçanta, kur plakesh nuk ngjitesh dot as në kat të dhjetë dhe as në të nëntin. Pra, kur plakesh, je person me aftësi të veçanta, si ata që janë në jetën e përditshme. Kjo duhet të jetë punë e përditshme e pushtetit vendor në bashkëpunim me shërbimin social shtetëror, që të krijojnë mundësi në marrjen e këtyre shërbimeve.

Ne nuk mund ta zgjidhim me shkruarjen e dy rreshtave në ligj. Kjo është punë e vazhdueshme që duhet bërë nga bashkitë dhe njësitë administrative, pra nga pushteti vendor në tërësi, por edhe nga shërbimi social shtetëror. Plakjen e kemi të gjithë përpara dhe është mosha më delikate.

Zoti Hyseni ka kërkuar fjalën për një pyetje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** – Më fal, zonja zëvendësministre, pyetjet i bëjmë ne dhe ju përgjigjeni.

Ne bëjmë një punë shumë të madhe për një kategori njerëzish që të mos paraqiten në mënyrë periodike dhe thamë që të dorëzojnë dokumentet, por në situatat ku njerëzit kanë humbur në mënyrë të përhershme aftësinë, për çfarë arsye duhet të dorëzojë dokumente një herë në 2 vjet apo në 1 vit. Këtë mund ta zgjidhim tani, sepse e kemi në dorë. Nuk ka nevojë që një person, të cilin komisioni e konsideron me aftësi të përhershme, të çojë dokumentet çdo vit, nuk ka nevojë as për dosje, duhet ta heqim, nga ana tjetër t'u lëmë të drejtën institucioneve të bëjnë verifikimin me analizë risku nëse kjo qëndron pas një periudhe kohe. Këtë duhet ta saktësojmë, prandaj më mirë ta vonojmë pak ligjin dhe ta bëjmë mirë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Lidhur me këtë kategori, a ka një përgjigje?

**Bardhylka Kospiri** – Në kategorizim ka edhe persona të përhershëm që nuk dalin në komision. Ata dosjen e kanë të depozituar, sepse për arsye të tjera shëndetësore ata mund të rëndohen dhe duhet të kenë një historik. Ata persona janë të klasifikuar me aftësi të kufizuar të përhershme dhe nuk shkojnë më në komision, por dosja e tyre depozitohet te pushteti vendor, ndërsa për ata që janë të rënduar shërbimi shëndetësor ka për detyrë t'i ndjekë në çdo moment.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Më fal, kam një pyetje dhe pastaj do t'ia kaloj fjalën relatores për një përmbledhje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këtu përgjigjet qeveria që ka sjellë ligjin, relatorja përgjigjet për komisionin dhe jo për qeverinë.

Zonja Kospiri, kam një pyetje, nuk e di nëse është objekt i këtij ligji, personave që dalin në kemp u kërkohet që vitin e fundit të kenë një periudhë të siguruar me sigurime shoqërore, pra Komisioni i Shëndetësisë jep që ky person duhet të përfitojë ndihmë, i thonë: “Nuk e përfiton, sepse vitin e fundit nuk ke qenë i siguruar”. Një njeri, që deklarohet i paafte për punë, nuk ka si të ketë qenë i siguruar vitin e fundit. A e zgjidh ky ligj këtë situatë, apo nuk është objekt i këtij ligji?

**Bardhylka Kospiri** – Nuk është objekt i këtij ligji, zoti kryetar.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

**Bardhylka Kospiri** – Kam diçka të fundit për mënyrën si do të merret pagesa, për të cilën ju thatë se duhet zgjidhur. Në vendimin e vitit 2009, në mos gaboj, thuhet: “Pagesa merret nëpërmjet postës apo në bankë”, por e vendos personi në bashkëpunim me bashkinë. Mund të ketë

raste kur bashkia i unifikon, por personi ka të drejtë ta përfitojë dhe në këtë pjesë duhet punuar me bashkitë. Personi ka të drejtë të zgjedhë nëse do të shkojë vetë në bankë ose të shkojë posta në shtëpi.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Kospiri!

Fjalën e ka zonja Bushka si relatores.

Bëni një përmbledhje koncize: cili është objekti konkret dhe çfarë mbulon ky projektligj? Në thelb projektligji është shumë i mirë.

**Klotilda Bushka** – Paraprakisht, më vjen mirë që kolegët ngrënë shqetësime. Jam dakord me zotin Hyseni, që thotë: “Ne jemi socialistë dhe duke qenë se jemi të prirur ndaj politikave sociale, sapo na vjen një ligj, i cili ka të bëjë me çështjet sociale, me shqetësimet që hasim çdo ditë, duam t’i zgjidhim të gjitha në atë ligj”. Shqetësimet tuaja janë të drejta, por nuk i zgjidh ky ligj të gjitha problemet. Me këtë ligj zgjidhim pagesën e ndihmës ekonomike, pagesën e aftësisë së kufizuar dhe çekun e bebeve, të cilat janë plus pagesave të tjera që marrin kategoritë. Personat me aftësi të përkohshme apo të përhershme, qoftë në punë, qoftë të lindur, marrin pensione të posaçme në bazë të ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Për sa i përket asistencës sociale që po flasim këtu, bëhet fjalë për një pagesë ekstra që u jepet kategorive të veçanta për të përballuar një pjesë të shërbimeve, të cilat ata nuk mund t’i gëzojnë si të gjithë shtetasit e tjerë.

Kryetari pyeti me të drejtë: si mund të zgjidhen në këtë ligj personat me statusin e paraplegjikut apo tetraplegjikut, të cilët, nëse nuk janë të siguruar vitin e fundit, nuk e përfitojnë? Nuk mund të zgjidhen, sepse nuk janë objekt rregullimi në këtë ligj. Duhet të jenë pjesë e rregullimeve në ligjin tjetër që parashikon pensionet e posaçme të aftësisë në punë.

Ne duhet të jemi të qartë. Po flasim për disa pagesa plus të atyre, që në zhargonin e përditshëm jemi mësuar të gjithë ta dimë se janë pagesa që marrin kategoritë në nevojë, personat me aftësi të kufizuar apo personat me ndihmë ekonomike.

Për sa i takon shqetësimin që ngriti me të drejtë zoti Hyseni, që ky përkufizim është i vështirë dhe nuk kuptohet, është standard, sipas ndihmës ekonomike që ndodh në të gjithë botën, rrjedhojë e një reforme më shumë se 10-vjeçare e shtetit shqiptar me Bankën Botërore dhe formula është e pranuar tashmë nga ne.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, mënyra e përkufizimit është në bazë të standardeve për këto ndihma.

Kam në sugjerim për ju. Kur të vijmë te diskutimi nen për nen, jeni i lirë, si çdo anëtar tjetër i komisionit, ta përkufizoni më qartë se e ka sjellë qeveria, nëse nuk është e qartë për ju.

Për sa i takon merakut, që ky përkufizim mund t'i pengojë njerëzit ta kuptojnë, po ju shpjegoj se në nenin 16 të projektligjit thuhet shumë qartë: “Aplikimi dhe përfitimi i ndihmës ekonomike”, ku mishërohet ajo që ju shpjegova që në fillim, deregulimi dhe thjeshtëzimi i procedurave. Nëse e shikoni, është e parashikuar qartësisht se aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet direkt tek administratori shoqëror, që ka çdo person te lagjja e vet. Pra, paraqitesh atje vetëm me kartë identiteti; administratori plotëson dhe hedh në sistem dokumentet dhe vendimi i Këshillit të Ministrave parashikon kushtet dhe kriteret që përfitohen. Qytetari nuk bëhet më pingpong në zyrat e shtetit, se ku do të shkojë, çfarë dokumentesh do të çojë dhe cilat janë kriteret. Në ligj parashikohen: qartësia; procedurat që ndiqen; ku do të bëhet aplikimi; deregulimi, thjeshtëzimi i procedurave dhe paraqitja e dokumenteve. Mendoj se e kemi arritur qëllimin, që njerëzit, të cilëve u takon, ta përfitojnë sa më lehtë shërbimin që, në fakt, nuk është një shërbim, por një pagesë. Këtë dua ta ndaj, sepse në këtë ligj nuk po flasim për shërbime shoqërore, por për pagesa të ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të çekut të bebes. Shërbimet shoqërore, sociale dhe pensionet e paaftësisë në punë parashikohen në ligje të tjera. Mbajini shënim shqetësimet që keni, që kur të vijmë ligjet, t'i kemi në konsideratë për t'i adresuar. E vetmja gjë që duhet ta themi ka të bëjë me faktin që niveli i ndihmës ekonomike si tavan 8 mijë lekë, është hequr. Nuk ka më tavan dhe kjo ka rëndësi, sepse ulja e abuzivitetit me skemën dhe heqja e përfituesve të padrejtë ka bërë të mundur të akumulohen para, që do të ndahen tek ata që i përfitojnë dhe nuk ka pse të ketë një tavan, pasi do të jetë i përcaktuar herë pas here në bazë të aftësive paguese që do të ketë shteti. Sa më mirë të menaxhohet ndihma, aq më shumë të ardhura do të ndahen te kategoria përfituese.

Për sa u takon pyetjeve të zonjës Hysi, theksoj se zonja Kospiri u përgjigj qartë. E vetmja gjë që dua të jetë e qartë për publikun ka të bëjë me faktin që ata persona, që, fatkeqësisht, kanë një aftësi të përhershme, nuk kanë nevojë të shkojnë herë pas here. Kjo çështje ka të bëjë me informimin publik. Ata që janë në nivel lokal, japin shërbime dhe informacione, qoftë shërbimi social, qoftë shërbimet sociale pranë bashkive, duhet të informojnë qytetarët për mënyrën si aplikohet, cilat janë procedurat, shpeshësia e aplikimeve dhe ta bëjnë të qartë për personat, që, fatkeqësisht, e kanë të përhershme paaftësinë dhe nuk kanë pse të paraqiten në komisione.

Zonja Kospiri, shqetësimet që ngrenë kolegët vijnë nga dëgjesat që ne bëjmë çdo javë me publikun në zonat tona elektorale. Kjo nuk do të thotë se ka një mangësi në ligj, të cilin ne duhet ta adresojmë, sepse do të ishte shumë e thjeshtë, mund ta parashikonim të gjithë së bashku dhe bëhej e plotë. Problemi vjen nga mungesa e informacionit, që zyrat e shërbimit në nivel lokal nuk i japin njerëzve, ose ua japin, por njerëzit nuk ua vënë veshin. Në këtë drejtim duhet punuar më shumë.

Zoti kryetar, në përfundim them se është ezauruar çdo çështje për këtë projektligj. Nëse nuk ka pyetje apo diskutime, të kalojmë në miratimin në parim. E shpjegova në fillim të kësaj seance, që ne jemi gati edhe për miratimin nën për nen, por si do ta gjykoni ju.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

Nuk besoj se ka pyetje dhe diskutime të tjera nga kolegët.

Unë jam dakord të votojmë sot në parim, ndërsa diskutimin, shqyrtimin, miratimin nën për nen dhe në tërësi të këtij projektligji t'i shtyjmë për mbledhjet e radhës në rast se kolegët kërkojnë kohë për të bërë sugjerime konkrete për nen të caktuara.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Në rast se nuk ka, mund ta kalojmë edhe sot.

Fakti që projektligji i sotëm mori një kohë prej një orë e gjysmë diskutim në parim, flet për rëndësinë e tij, por edhe për reflektimin e shumë shqetësimeve që kolegët e mi deputetë, jo vetëm anëtarë të Komisionit të Ligjeve, por edhe të tjerë, marrin në zonat e tyre nga qytetarë të Republikës së Shqipërisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Hysi, ju lutem!

Të jemi të qartë. Ky projektligj ka faturë financiare në buxhetin e shtetit. Asistenca sociale përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit. Qeveria përcakton masën e portofolit që ka për të mbështetur me asistencë sociale këtë rreth subjektsh që janë përcaktuar në nenet 7, 8, 9 dhe 10 të këtij projektligji. Është një fond solidariteti shoqëror...

9 Neta ligje dt.08.07.19

që shoqëria e jep për familjet në nevojë, për jetimët, për prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh, për viktimat e trafikimit, për viktimat e dhunës në familje, për paraplegjikët, tetraplegjikët, për personat me aftësi të kufizuar, për personat me aftësi të kufizuar të deklaruar me



vendim të një komisioni shumë disiplinor të vlerësimit të aftësive të kufizuara, për personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune, por me vendim të komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë, pra është një fond solidariteti.

Mendoj se nëse ky projektligj, në variantin që është paraqitur dhe, me sa u prezantua sot nga zëvendësministrja, por edhe nga relatorja, por edhe që u qartësua për kolegët e mi deputetë me pyetjet dhe përgjigjet që u dhanë, ka gjetur një mekanizëm ligjor, të duhurin, që ky fond solidariteti të shkojë tamam te këto subjekte që u takon, ai meriton votën tonë. Ky fond deri më sot është përdorur për joshje elektorale. Le ta themi hapur dhe për këtë meriton falënderime qeveria, e cila që në mandatin e parë, por edhe tani e ka nisur si pilotim formulën dhe mekanizmin e shpërndarjes së ndihmës ekonomike dhe të asistencës sociale dhe sot vijmë me një projektligj të integruar, që do ta zgjidh një herë e mirë në të gjithë Shqipërinë këtë problem. Pilotimi në 3-4 bashki tregoi qartë se kategoria e subjekteve, të cilët përfitonin asistencën sociale dhe ndihmën ekonomike, nuk ishin ata, për të cilët realisht shoqëria duhet të nxjerrë nga xhepi dhe t'u vijë në nevojë.

Mendoj se ky projektligj e ka zgjidhur këtë situatë. A mund ta zgjidhë të gjithë gamën e shqetësimeve dhe të nevojave që ka shoqëria apo kjo kategori subjektsh shoqërore për t'u trajtuar ndryshe nga shoqëria? Nuk e zgjidh. Ne e dimë se sa është buxheti i shtetit, ne e dimë çfarë resursesh dhe potencialesh ekonomike kemi si shtet, do të kishim dëshirë që masa e asistencës sociale të mos ishte në ato përmasa që është, por të ishte shumë më e madhe, por kjo është mundësia financiare që kemi sot. Ndaj, dua t'ju falënderoj të gjithëve për përfshirjen në këtë debat dhe diskutim me shumë vlerë, me radhë të gjithë kolegët, nga zoti Fino, zonja Bushka, zonja Hysi, zoti Hyseni dhe zonjën Kospiri!

Ju falënderoj për kontributin! E hedhim në votim në parim projektligjin!

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit. Keni një tabelë bashkëngjitur, që reflekton sugjerime dhe komente të caktuara për nene të posaçme.

Neni 1 “Objekti”.

Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Fusha e zbatimit”.

Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3 “Fusha e zbatimit”.

Neni 4 “Parime të përgjithshme”.

Kush është dakord?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka propozime për nenin 4. Relatorja sugjeron që të bëhet neni 5 i projektligjit.

Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Edhe këtu ka një sugjerim: germa “o” e nenit 5, të riformulohet sipas variantit që është në tabelë.

Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 i përket kreut II “Përfituesit e asistencës sociale”.

Neni 6 “Asistenca sociale”.

Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7 “Subjektet përfituese të ndihmës ekonomike”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, me ndryshimet që keni në tabelë. Jua thashë që në fillim: ndryshimet i keni në tabelën bashkëlidhur në kolonën e fundit të tabelës.

A keni pyetje?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Besoj se te përkufizimet e ka marrë përgjigjen edhe pyetja e koleges Mara. Kush është dakord me nenin 7, me sugjerimet e relatores? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8 “Subjektet përfituese të pagesës së aftësisë së kufizuar”. Edhe këtu ka një propozim për riformulim.

Kush është dakord me sugjerimin? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9 “Subjekti përfitues i ndihmës së menjëhershme financiare, bonusi i bebes”.

Kush është dakord me ndryshimet që propozohen? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 10 “Subjektet përfituese të ndihmës personale”. Këtu është ndryshuar titulli i nenit “Përfituesit e ndihmës personal”.

Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11 “Subjektet jopërfituese”. Edhe këtu ka propozim për riformulim nga relatorja.

Kush është dakord me nenin 11, me propozimet për riformulim? Kundër? 2 kundër.  
Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu III “Llojet e përfitimit të programeve të asistencës sociale”. Ky kre fillon me nenin 12 “Pagesa e ndihmës ekonomike”. Edhe për nenin 12 ka riformulim.

Kush është dakord me riformulimin? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Pagesa e aftësisë së kufizuar”. Për nenin 13, nuk ka riformulim. Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14 “Pagesa për ndihmën e menjëhershme financiare”. Nuk ka propozim për riformulim.

Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu IV “Kriteret dhe procedurat e përfitimit nga programet e asistencës sociale”. Ky kre fillon me nenin 15 “Përjashtimi nga ndihma ekonomike”. Edhe për këtë nen nuk ka sugjerime për riformulim.

Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16 “Aplikimi dhe përfitimi i ndihmës ekonomike”. Ka riformulim të këtij neni, sipas tabelës së bashkëngjitur.

Urdhëroni, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Më duket diskriminuese për burrat, sepse thotë “Të drejtën për ta tërhequr dhe për ta marrë në dorëzim ndihmën ekonomike për familjet në nevojë e ka bashkëshortja e kryefamiljarit. Për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon, pra ka vdekur apo nuk është, të drejtën e ka kryefamiljari”. Nuk e kuptoj si është bërë kështu kjo dispozitë?!

**Ulsi Manja** – Në fakt, është diskriminim pozitiv, kështu që e kemi pranuar, zoti Fino.

**Bashkim Fino** - Mund ta pranosh ti, por nuk e pranoj unë, sepse për pjesën që kryefamiljari ka grua, do ta marrë gruaja, për pjesën që kryefamiljari nuk ka grua, do ta marrë kryefamiljari. Çfarë kuptimi ka kjo?!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kjo nuk vihet në ligj.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Në rregull, por pse duhet të lihet kështu në ligj?! Ta lëmë kryefamiljari, ose ta marrë familja, sepse kështu si e vëmë ne...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** - Kush është dakord me nenin 16?

Urdhëroni, zonja Bushka!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Klotilda Bushka** - Është politikë sociale e qeverisë shqiptare që në vitin 2013 që ndihmën ekonomike si pagesë ta marrin gratë, sepse në zona të caktuara nuk ka shkuar për t'i shërbyer familjes, por ka shkuar që t'u shërbejë vetëm kryefamiljarëve burra.

**Ulsi Manja** - Zoti Fino, ka qenë pjesë e programit të qeverisë për zgjedhjet e vitit 2013.

**Bashkim Fino** - Megjithëse, argumenti që dha relatorja është ngatërrues, neni 16, pika 5 është diskriminues. Duhet të pyesim Komisionerin kundër Diskriminimit, a lejohet kjo gjë? Dua të di: a e kanë pyetur Komisionerin kundër Diskriminimit për këtë gjë? Është diskriminues.

**Ulsi Manja** - Është pyetur.

**Bashkim Fino** - Nuk mund ta pranoj që të diskriminohen burrat.

**Ulsi Manja** - E hedhim në votim nenin 16.

Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 17 “Përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar”. Nuk ka riformulim për nenin 17. Kush është dakord me nenin 17? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 “Përftimi nga skema e sigurimit të kujdesit shëndetësor”.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu V “Drejtimi dhe administrimi i programeve të asistencës sociale”. Ky kre fillon me nenin 19 “Roli i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale”. Nuk ka sugjerime.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

**Ulsi Manja**- Neni 20, “Roli i shërbimit social shtetëror”. Nga relatorja ka një reformulim për nenin 20. Kush është pro nenit 20 me sugjerimin? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 20.

Kalojmë te neni 21, “Roli i këshillit bashkiak”. As ky nen nuk ka sugjerime. Kush është pro nenit 21? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 22, “Roli i strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki”. Për këtë nen zoti Fino ka bërë vërejtje. Kush është pro? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 23, “Roli i administratorit shoqëror në njësinë administrative”. Kush është pro? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te kreu VI, “Financimi i programeve të asistencës sociale”. Ky kre fillon me nenin 24, që është financimi i programeve të asistencës sociale. Nuk ka sugjerime nga relatorja. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25, “Programi i fondeve”. Edhe për nenin 25 nuk ka sugjerime. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26, “Transferimi i fondeve”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 27, “Kontrolli i fondeve”. Ka propozim për reformulim nga relatorja. Kush është pro nenit 27 me reformulimin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu VII, “Sanksionet dhe procedura e ankimit”. Ky kre fillon me nenin 28, që janë sanksionet. Ka propozime për riformulim nga relatorja. Kush është pro nenit 28 me riformulimet? Po, zoti Fino ka vërejtje.

**Bashkim Fino**- Si mund të vihen sanksione për organet e pushtetit vendor? Këtu thuhet: “Struktura përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, për pagesën për personat me aftësi të kufizuar, domethënë për shkelësit, i propozon kryetarit të njësisë administrative, ose drejtorit të Përgjithshëm të shërbimit social vendosjen e gjobës nga 50 mijë deri në 100 mijë: masës disiplinore për organet e pushtetit vendor”.

Si do të vendosë drejtori i përgjithshëm gjobë për punonjësin e bashkisë, apo masë disiplinore?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ai i vendos gjobë nga 50 deri në 100 mijë lekë.

**Ulsi Manja**- Kryetari i bashkisë....

**Bashkim Fino**- Më thoni kujt i vihet gjoba?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pse?

**Ulsi Manja**- Propozim është.....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bashkim Fino**- Jo, nuk është kështu pra. E ke gabim...

**Ulsi Manja**- Kush është dakord me nenin 28, me riformulimin që propozon relatorja? Kundër? Dy kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë të neni 29, “Ankimi”. Edhe për ankimin, në nenin 29 ka një propozim për riformulim. Kush është pro nenit 29? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet neni 29.

Kalojmë te kreu VIII, që është edhe kreu i fundit, i cili fillon me nenin 30, “Vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar” .

Neni 30 nuk ka propozim për riformulim. Kush është dakord? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 31, “Dispozita kalimtare”. Kush është pro? Kundër një. Asnjë abstenim.  
Miratohet.

Neni 32, “Aktet nënligjore”. Ka propozim për riformulim nga relatorja për pikën 1 të nenit 32. Kush është pro nenit 32 me riformulimin e propozuar? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 33, “Shfuqizime”. Edhe këtu ka propozime për riformulime. Kush është dakord me nenin 33? Kundër një. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 34, “Hyrja në fuqi”. Kush është dakord me nenin 34? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj bashkë me raportin përkatës t’i përcillet komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Shumë faleminderit për diskutimin!

Zonja Kospiri, së bashku me stafin, shumë faleminderit për prezencën! Ditë të mbarë dhe javë të mbarë!

**Bardhylka Kospiri-** Faleminderit juve!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.07.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për mbrojtjen civile”.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Ediola Braha, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Korab Lita dhe Elena Xhina

**Mungojnë:**

Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Damian Gjikhuri, Alban Zeneli, Elda hoti dhe Tom Doshi

**Të ftuar:**

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Haki Çako - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC) në Ministrinë e Mbrojtjes

Ismail Shehu - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

Maksimiljan Dhima - Drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit, pranë DPEC-së në Ministrinë e Mbrojtjes



**Ulsi Manja** -Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, që është projektligji për mbrojtjen civile. Relator është kolegu Edmond Leka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Mbrojtjes, zoti Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes, zoti Haki Çako, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe zoti Ismail Shehu, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatorë në Ministrinë e Mbrojtjes

Zoti Koçi, ju uroj mirëseardhjen në komision dhe ju kërkoj ndjesë edhe për vonesën, sepse projektligji për asistencën sociale zgjati më shumë se sa duhet, por besoj se ia vlejti diskutimi.

Po jua kaloj fjalën pa humbur kohë për të bërë një prezantim të shkurtër të këtij projektligji dhe më pas do t'ia kaloj fjalën kolegut Leka. Zoti Koçi, fjala është për ju.

**Petro Koçi**- Faleminderit zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë, të nderuara deputete, do të mundohem të bëj një prezantim fare shkurt. Ky është një projektligj, i cili inicion qysh nga ngjarjet e fatkeqësisë së vitit 2017. Besoj se i mbani mend përmbytjet në Republikën e Shqipërisë, ku në bashkëpunim me disa agjenci të huaja ne kemi filluar shqyrtimin e të gjithë sistemit të reagimit ndaj fatkeqësive dhe, praktikisht, pas një kohe shumë të gjatë, prezantojmë si qeveri projektligjin “Për mbrojtjen civile”, i cili synon zvogëlimin e riskut nga fatkeqësisë dhe realizimin e mbrojtjes civile, si sistem, por edhe më pas si përgjegjësi duke filluar që nga individët, te subjektet dhe deri tek agjencitë e ngritura qëllimisht në shërbim të këtij qëllimi, për të mbrojtur jetën e njerëzve, pronën dhe natyrisht gjënë e gjallë, trashëgiminë kulturore, mjedisin e të tjerë. Projektligji ka si objektiv identifikimin e saktë, vlerësimin periodik, monitorimin e riskut të fatkeqësive dhe natyrisht investimin për parandalimin e këtyre risqeve, duke intensifikuar bashkëpunimin me shumë subjekte, por kryesisht me subjekte, të cilat, në përputhje me ligjin, kanë detyrime përkundrejt qëllimit të ligjit.

Gjithashtu ligji ka për objektiv forcimin e sistemit të mbrojtjes civile nëpërmjet krijimin të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, por edhe të agjencive të tjera në nivel lokal dhe vendor. Dua t’ju them se nga pikëpamja e integritit europian ky është një projektligj i rëndësishëm, sepse për afron legjislacionin për 4 direktiva, nuk është vendi besoj për t’i përmendur të katërt direktivat, por nga ana tjetër plotëson dhe integrohet thuajse plotësisht me kuadrin “Sendai” të Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu, garanton që pas aprovimit të këtij ligji Agjencia jonë Kombëtare e Mbrojtjes Civile të integrohet në mekanizmin europian të mbrojtjes civile.

Për ta hartuar ligjin ne jemi mbështetur në disa bashkëpunime, duke filluar nga Departamenti i Mbrojtjes Civile te Italisë dhe kemi shfrytëzuar modele, siç është modeli slloven, pse jo edhe modeli i Kosovës, por jemi mbështetur edhe në praktikën tonë në zbatim të ligjit aktual të Emergjencave Civile, i cili duhet pranuar është një ligj, që tashmë quhet i konsumuar dhe nuk mund të përballojë detyrimet që duhet të ketë shoqëria dhe shteti për të zvogëluar risqet që vijnë nga fatkeqësitë, e cila duhet pranuar që është një axhendë dhe një detyrim tashmë ndërkombëtar, thuajse global. Çdo ditë mund të shohim kronika për pasojat që sjellin fatkeqësitë e ndryshme natyrore apo fatkeqësitë që vijnë nga papërgjegjshmëria e njerëzve apo nga aksidentet pothuajse në të gjithë globin. Kështu që besoj se është një ligj i rëndësishëm edhe në axhendën parlamentare, i cili, në fakt, duhet të ishte përfunduar brenda gjashtë muajve të parë të këtij viti, por gjithsesi jemi brenda këtij sesiioni dhe do të donim që të aprovohej në datën 18 korrik, në seancën e fundit parlamentare.

Faleminderit!

**Ulsi Manja**- Po, shumë faleminderit zoti Koçi!

Zoti Leka e ka fjalën.

**Edmond Leka**- Faleminderit kryetar!

Ashtu siç e shpjegoi edhe zëvendësministri, projektligji ka si qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, trashëgimisë, mjedisit dhe forcimit të mbrojtjes civile. Ky projektligj vjen në momentin e duhur, duke pasur parasysh edhe përmbajtjet e mëdha që kanë ndodhur në qarqet Shkodër, Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier, ku në shumë raste janë gjetur të papërgatitur edhe banorët, por edhe disa nga institucionet e qeverisjes vendore.

Projektligji rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar; të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private; edukimin, trajnimin dhe inspektimin në fushën e mbrojtjes civile.

Objektivat e projektligjit janë: zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë nëpërmjet identifikimit të saktë, vlerësimit periodik të riskut dhe monitorimit të tij; forcimi i sistemit të mbrojtjes civile nëpërmjet krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; forcimi i kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile në tërësinë e tij; përmirësimi i edukimit për mbrojtjen civile në shkolla, nëpërmjet përfshirjes së lëndëve përkatëse arsimore në

nivelin arsimor parauniversitar; mirëfunksionimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm, i monitorimit, njoftimit dhe alarmit, duke përcaktuar detyrat për institucionet përgjegjëse dhe subjektet private, të përfshira në të; parashikimi i rregullave më të qarta të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij ndërinstytucional në kuadër të asistencës ndërkombëtare dhe të procedurave përkatëse; rritja e rolit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile, nëpërmjet përcaktimit të të drejtave dhe detyrave që ato kanë në këtë fushë.

Ne kemi propozuar disa ndryshime nen për nen, të cilat ia propozojmë edhe komisionit përgjegjës, por disa çështje, që mund t'i diskutojmë këtu në komision, janë ndryshime në nenet 28 dhe 65 të projektligjit. Parashikohet se 4% e buxhetit vjetor të bashkive duhet të planifikohet për mbrojtjen civile.

Lidhur me këtë detyrim, së pari, duhet të vlerësohet nëse bie ndesh me parimet e autonomisë së qeverisjes vendore, të cilat kanë autonomi të plotë fiskale në përcaktimin e mënyrës së përdorimit të fondeve të tyre buxhetore. Gjithashtu, ky vlerësim duhet bërë për të qartësuar nëse masa 4% është mbi fondet e kushtëzuara apo mbi buxhetin vjetor të bashkisë.

Duke qenë se në këtë projektligj parashikohen disa funksione të reja, që do të kryhen në kuadër të mbrojtjes civile, parashikimi dhe shtesa e fondeve duhet të bëhet vetëm brenda fondit të transfertës së kushtëzuar. Edhe për nivelin 4% mendojmë që duhet diskutuar, madje mund të bëhet një parashikim nga 2% deri në 4%, me qëllim që të përcaktohet edhe në varësi të riskut, pasi bashkitë mund të mos kenë të njëjtin probabilitet në ndodhjen e fatkeqësive natyrore.

I njëjti problem qëndron edhe për detyrimin që në ligj u vendoset ministrive dhe institucioneve qendrore, që në planifikimin e buxhetit të parashikojnë 2% deri në 4% të totalit të buxhetit për mbrojtjen civile. Edhe ky parashikim duhet parë në raport me përcaktimet e legjislatcionit “Për buxhetin e shtetit”.

Po kështu, në projektligj janë parashikuar disa detyrime dhe përgjegjësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore në kuadrin e mbrojtjes civile.

Nga propozuesit e projektligjit duhet të sqarohet nëse janë konsultuar paraprakisht me përfaqësuesit e vetëqeverisjes vendore për këto funksione të reja që u janë shtuar.

Po kështu, duhen vlerësuar në projektligj edhe kompetencat që i jepen prefektit në rastin kur i jepet e drejta që të kthejë buxhetin e bashkisë, sepse nuk është bërë planifikimi i masës 4% për mbrojtjen civile.

Projektligji ngarkon edhe subjektet private me mbi 20 punonjës me detyrimin që të sigurojnë me shpenzimet e tyre pajisjet e alarmit për punonjësit dhe komunitetin, si dhe të garantojnë funksionimin e tyre.

A është bërë ndonjë vlerësim se sa do të jetë kjo kosto, që duhet të përballojnë këto subjekte private?

Pastaj, kur të vijmë në shqyrtimin nen për nen, zoti kryetar, kemi disa propozime që mund t'i shqyrtojmë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Leka!

Ka pyetje nga kolegë të tjerë, përveç atyre që bëri relatori?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjalën e ka zoti Koçi, në përgjigje të pyetjeve që bëri relatori, zoti Leka, për të vijuar me kolegët.

**Petro Koçi** – Duke e filluar nga masa 4%, bëhet fjalë për masën 4% të fondit të kushtëzuar që qeveria e jep për pushtetin vendor, jo 4% të buxhetit vendor të pavarur që ka vetë bashkia.

Ligji është konsultuar me të gjitha ministritë. Pra, lidhur me shqetësimin tuaj nëse ministritë kanë qenë ose jo dakord lidhur me detyrimet që kanë, ku përfshihen edhe angazhimet financiare, ato kanë rënë dakord. Ndërsa konsultimi me këshillin konsultativ nuk është bërë, sepse ai nuk ka qenë i konstituar në kohën kur ne jemi marrë me hartimin e këtij projektligji.

Ndërkohë, ligji është një pjesë e detyrimit që ne kemi në kuadrin e integritimit evropian, madje duhej të ishte aprovuar brenda gjashtëmujorit të parë të këtij viti, por për shkak të disa vonesave, mbërrijmë deri këtu. Thënë kjo, do të donim që të kalonte me patjetër në seancën plenare të datës 18.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Koçi!

**Edmond Leka** – Edhe diçka, zoti kryetar.

Ne prandaj e kemi propozimin për bashkitë e veçanta nga 2% deri në 4%, sepse edhe niveli i riskut nuk është i njëjtë për të gjitha bashkitë. A mos duhet bërë një përcaktim sipas bashkive?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Leka!

Fjalën e ka zoti Çako për t'u përgjigjur.

**Haki Çako** – Nëse mund të sqaroj diçka, me bashkitë është konsultuar edhe në mënyrë elektronike, edhe në komunikimet e mundshme me to. Përqindja është marrë në konsideratë, pasi edhe sasia e buxhetit për bashkitë korrespondon qoftë me intensitetin e sipërfaqes, qoftë edhe të fatkeqësive që ndodhin në bashki të caktuara.

Gjithsesi, në vijim të asaj çfarë tha zoti zëvendësministër, kjo është një përqindje, e cila korrespondon me buxhetin e akorduar nga qeveria. Ne e kemi marrë në konsideratë, pasi shumica e bashkive aktualisht në të gjitha fatkeqësitë natyrore të ndodhura gjenden përballë një pamundësie për të buxhetuar, si të thuash, minimumin e mundshëm për të përballuar situata të tilla të jashtëzakonshme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ligji ka marrë në konsideratë në mënyrë të përpjesëtuar edhe përgjigjen që do të bëhet mbi bazën e parimeve të përcaktuara qartë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çako!

Kush e do fjalën për pyetje nga kolegët?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Faleminderit!

Projektligji i ardhur këtu është i saktë dhe i drejtë dhe duhet ta miratojmë sa më shpejt, sepse do t'i shërbejë jo vetëm ministrisë së linjës, që e mbulon mbrojtjen civile, por edhe gjithë komunitetit.

Tani, ajo që unë dua të them në lidhje me këtë projektligj, të cilin e kam lexuar aq sa kam pasur mundësi, është se disa nene më kanë bërë të reagoj: nenet 28 dhe 65. Dua t'u them kolegëve, por edhe zëvendësministrit që në ligjin e parë të organeve të pushtetit vendor diku është vënë që ky fond do të ishte deri në 3% nga organet e pushtetit vendor. Në vitin 2015, kur ne bëmë ndarjen e re administrative dhe ligjin e ri të organeve të pushtetit vendor, nuk e kemi marrë në konsideratë për ta trajtuar një gjë të tillë. Ndërkohë, sot ju na sillni një ligj me anën e të cilit i detyroni organet e pushtetit vendor që fondet për emergjencat civile t'i kenë në masën 4%. Në fakt, kjo është e gabuar, bashkë me përgjigjen që dhatë ju, kur thatë se fondi është i kushtëzuar, pra i qeverisë.

Pushteti vendor ka dy fonde, njëri fond është i pakushtëzuar, pra që e dërgon qeveria si fond të pakushtëzuar dhe fondet e tjera, të cilat krijohen nga vetë organet e qeverisjes vendore.

Fondin e pakushtëzuar e vendos këshilli bashkiak se si e ndan. Në qoftë se ti i thua: “Unë po të jap 100 lekë, por 4% të këtij 100-lekëshit, që ta kuptoni ju, ti nuk do ta prekësh dhe do ta

ruash për emergjencat civile, mbaje ti më mirë, se njësoj e ke. Mos e jep. Mbaje ti në qendër atje dhe je në rregull”, nuk mund t’u vësh sanksione organeve të pushtetit vendor, sepse nuk të lejon ligji i pushtetit vendor. Mbaje atje, jepja 4% më pak, meqenëse e ke vendosur 4.

Pyetja ime është: pse 4% dhe jo 7%, jo 5%? Në ligjin e mëparshëm ka qenë 3% (e njoh mirë ligjin e pushtetit vendor), që e kemi hequr dhe nuk është më. Për ndarjen e territoriale duhet bërë studim edhe për riskun më të madh të problemeve dhe fatkeqësive, për të cilat, për hir të së vërtetës, në Shqipëri kemi një bazë të dhënash dhe një hartë, le të themi, duke përjashtuar tërmetet e fuqishme, ishallah të mos ndodhin! Për pjesën tjetër, që na ka ndodhur, si përmbytjet e të tjera, në njëfarë mënyre, i kemi këto mundësi për ta parë.

E dyta, ne nuk duhet të harrojmë që qeveria ka edhe një fond të veçantë dhe ne, kur miratojmë buxhetin këtu në dhjetor, miratojmë edhe fondin e veçantë, të cilin e miratojnë edhe organet e pushtetit vendor, madje këto të fundit, kur miratojnë buxhetin, kanë një fond të veçantë, që edhe ky është një thes nga i cili...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Para se të ikë Adnori, zoti kryetar, ta dëgjojë edhe këtë: ka një fond të veçantë që mund ta përdorin edhe për këtë çështje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E treta, Adnor, neni 65, për shembull, bie ndesh me nenin 18. Pse? Çfarë thonë te neni 65 këta? Na thonë 4% në nenin 28, ndërkohë, kur vijmë te neni 65 “Buxheti i bashkive” (dhe e caktojnë me ligj, gjë që është në kundërshtim të hapur me ligjin) thonë: “Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore dhe mbrojtjes civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështetur në parashikimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit...”. Thotë “minimal”, se mund ta përdorësh edhe më shumë “...nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit (ajo që tha zëvendësministri dhe jemi okej), si më poshtë vijon: a) nga të ardhurat e veta vendore, b) nga fondet që vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve”, si dhe “c) nga burime të tjera të parashikuara me ligj”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në këto momente, me këtë nen ti i ke ndërhyrë te fondet e veta. Por ti nuk mund t’i thuash dot me ligj që si organ i pushtetit vendor do të krijosh 4% dhe do të ndërhysh tek të ardhurat e tua nga burime të tjera për ta krijuar... Pra, le të themi që kjo duhet parë pak më me qetësi që të mos ketë përplasje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti kryetar,

Zotërinj deputetë,

Më lejoni t'ju lexoj nenin 30, që është neni themelor i organeve të pushtetit vendor. Çfarë thotë ky nen?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Neni 30 i ligjit nr. 139, i vitit 2015.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, neni 30 i ligjit të pushtetit vendor me 3/5, thotë: “Funksionet dhe kompetencat e deleguara janë të detyrueshme ose jo të detyrueshme”. Pra, qeveria mund t'i delegojë një funksion organit të pushtetit vendor, që është i detyrueshëm ose jo i detyrueshëm. Pika 6 e këtij neni, thotë: “Në çdo rast, qeverisja qendrore u garanton njësisive të qeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara”. Pra, do të thotë që unë ia kam dhënë kompetencat me ligj me 3/5 organit të pushtetit vendor, por në qoftë se do t'i jap një funksion të ri, do t'i jap bashkëngjitur edhe faturën financiare. Pa këtë nuk mund ta jap dot. Ti mund të ma japësh mua si kryetar bashkie, por unë them piqu në diell, sepse nuk kam lekë dhe nuk ta jap dot, sepse unë zbatoj nenin 30 të ligjit tim. Nëse nuk më jep fonde, unë nuk mund ta bëj një gjë të tillë.

Pra, në funksion të këtyre, unë mendoj (e kam për relatorin, për zëvendësministrin, por edhe për këshilltarët tanë) që nenet 28, 65, në funksion me nenin 30, “Funksionet dhe kompetencat të deleguara të qeverisjes vendore”, duhet të jetë në unison të plotë. Në të kundërt nuk mund të jetë në përplasje, sepse nuk mundet dot që ne të bëjmë një ligj dhe do të ngelet kështu.

Asnjë organ i pushtetit vendor, pavarësisht se ti i thua 4%, nuk do ta krijojë atë fond, nuk do të të japë dhe t'i nuk ke çfarë t'i bësh. Edhe masa sanksionuese që keni vënë, ku i thua prefektit të anulojë buxhetin, nuk e anulon dot. Buxhetin e bashkive prefekti ka të drejtë ta kthejë vetëm një herë. E merr bashkia, e rishikon, e kalon përsëri ashtu siç e mendon këshilli bashkiak dhe nuk ka gjë në dorë prefekti t'i thotë që unë nuk ta miratoj buxhetin. Absolutisht jo. Madje, edhe këtu që e keni vënë po e përdorni keq prefektin. Edhe neni i prefektit këtu duhet hequr. Nuk mund të vëmë dot ne në ligjin e emergjencave civile që nëse nuk e kalon 4%-in, prefekti do t'i kthejë buxhetin. Absolutisht jo. Këto vërejtje kisha për këtë projektligj.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zoti Shameti, për procedurë.

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke vlerësuar maksimalisht të gjitha ndërhyrjet e gjetura të zotit Fino dhe duke qenë se kemi seancë në orën 17 : 00, do t'ju lutesha të bënim kalimin në parim të këtij projektligji, kurse të gjitha vërejtjet me vend të zotit Fino t'i shikojmë me lupë kur të bëjmë kalimin nen për nen.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Shameti!

Jam dakord me propozimin e zotit Shameti.

Ju lutem, zoti Koçi, jepni një përgjigje për shqetësimet që paraqiti zoti Fino.

**Petro Koçi** – Dua të sqaroju se 4%-i është dyshemeja e detyrimit që ka njësia e qeverisjes vendore kundrejt angazhimeve për të zvogëluar risqet nga fatkeqësitë. Pra, ata mund ta rrisin këtë dysheme në përputhje me proporcionalitetin e mundësive të fatkeqësive.

Neni 28 përcakton detyrimin e prefektit që ta kthejë buxhetin. Ai vepron njëjloj si edhe sot. Pra, në momentin që ai vlerëson se një akt i qeverisjes vendore nuk përputhet me legjislacionin, e kthen, ashtu siç bën edhe sot, një herë dhe pastaj bëhet ezaurimi në rrugë gjyqësore.

Për sa i përket nenit 65, ai m'u duk ...

**Ulsi Manja** – Zoti Koçi, kur të jemi në fazën e shqyrtimit dhe miratimit nen për nen ...

**Petro Koçi** – Dua të them që nuk e cenon. 4%-i është detyrimi nga fondet e kushtëzuara, pastaj përcakton burime të tjera. Nëse qeverisja vendore është e gatshme të përcaktojë burime të tjera, ka përcaktuar burime të ardhurat e veta vendore e të tjera. Nuk është detyrim nga ligji. Është “dhe nga burime financiare”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** - ... pse i thua, mbaj 4%? Po ia dhe fondin, mbaje vet dhe hajde te ne në parlament. Neni 16 është më fantastik akoma. Ai thotë: “Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile fillojnë nga Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile, Komiteti i Mbrojtjes Civile, Ministri përgjegjës për Mbrojtjen Civile, ministrat dhe institucionet qendrore, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Komisioni Teknik dhe qendrat e tjera me radhë. Çfarë dua të them me këtë? Kur t'i vjen në Kuvend, që në fakt është për buxhetin, thuaj që është një fond, të cilin, në qoftë se nuk ndodh asnjë fatkeqësi gjatë vitit, qeveria mund ta përdorë. Ndaj thashë ka edhe fondin rezervë. Ti si shtet thua që unë dua 5% apo



3% të GDP-së për fatkeqësitë natyrore dhe i mban dhe nuk u thua bashkie ta krijojnë ato 4%-in. Pastaj më thua që unë ia jap nga fondi i pakushtëzuar, por i them që 4% mos i harxho, sepse duhet ta mbash gjatë gjithë viti nëse ndodh ndonjë gjë në Lushnjë, Tiranë apo Tropojë. Derisa ja djeg, mos i jep 4%, por më pak dhe je në rregull me bashkitë. Bashkia do të ndihmojë me burime njerëzore, por shteti është i fuqishëm dhe shkon e ndihmon atje. Ti ia jep menjë dorë dhe me një vendim i thua 4% do ta mbaj këtu. Bile, po munde realizoje më shumë këtë fond.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Çako, jepni një konsideratë të fundit dhe pastaj do të kalojmë në votim.

**Haki Çako** – Thjesht dua të sqaroj një moment shumë të rëndësishëm në këtë projektligj. Ligji për emergjencat civile i miratuar në vitin 2001 nuk ka marrë dhe pasur në konsideratë reduktimin e riskut, tërësinë e masave paraprake për të parandaluar fatkeqësitë natyrore.

Shqipëria sot është një nga 10 vendet më të riskuara nga fatkeqësitë natyrore. Kjo është me statistika edhe në raportin e Bankës Botërore. Deri më sot, investimet e drejtpërdrejta për çështjen e fatkeqësive ose të katastrofave në Shqipëri janë shumë të pakta. Pse është marrë në konsideratë dyshemeja 4%? Është marrë që të gjitha organet e pushtetit të kenë mundësi të investojnë paraprakisht për reduktimin e riskut, për të identifikuar saktë dhe qartë ku e kanë riskun dhe të fillojnë të investojnë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çako!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** - Kam të drejtë të flasë. Ose ndërprit mbledhjen dhe e vazhdojmë nesër. Kemi seancë në orën 17:00 dhe duhet ta kalojmë ...

**Ulsi Manja** – Në parim do ta kalojmë sot edhe nëse ju jeni kundër.

**Bashkim Fino** – Patjetër dhe jam plotësisht dakord që ta kalojmë.

Deri në momentin që ai nuk po më kthente përgjigje, unë isha i qetë, tani që më ktheu përgjigje nuk jam i qetë. 4%-i nuk jepet për investime.

**Ulsi Manja** – Po merreni me një nen që do të merremi përsëri pas dy ditëve.

**Bashkim Fino** – 4%-i që do të krijojnë bashkitë është fond që ruhet atje nëse ndodh ndonjë emergjencë. Nëse më thua se nga statistikat e Bankës Botërore Shqipëria është një nga dhjetë vendet më të riskuara nga fatkeqësitë natyrore, e di se ku janë problemet dhe duhet që bashkitë të investojnë në një kanal apo diçka tjetër, kjo është e gabuar. Kjo është çështje e investimeve të qeverisë, ministrive e të tjera me radhë. 4%-i është një fond që ruhet atje nëse ndodh ndonjë gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Rehabilitimi është investim. Nuk është investim 4%-i. E ke gabim si koncept.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

**Petro Koçi** – Ligji ka parimin subsidiar. Do të thotë që reagimi fillon nga poshtë. Prandaj, 4%-i nuk mund të rrijë në duart e qeverisë, por duhet të rrijë në administrimin e organit të qeverisjes vendore.

**Bashkim Fino** – ... Ka mundësi 4% - i, sikur ky ligj të ishte në fuqi dhe të ishte zbatuar me korrektësinë më të madhe, zoti Petro? E zëmë se e krijoi 4%-in bashkia e Ersekës. Ra tërmeti, por nuk gjen dot mundësinë të zgjidhë të gjithë atë problematikë të kësaj emergjence. Detyrimisht do të ketë edhe solidaritetin e bashkive të tjera, por edhe të fondit të veçantë të qeverisë për ta bërë, sepse nuk e zgjidh dot me 4%.

Ndaj ju pyeta se kush e vendosi 4%-in. Apo e vendosni ju se duhet të jeni në rregull me NATO-n me buxhetin? Pse 4% dhe jo 2% apo 3%? Ku është studimi që ju e keni bërë 4%? Çfarë zgjidh ti me 4%-in e 61 bashkive dhe sa është fondi 61 bashkive për 4%, që t'i e ke të rezervuar gjatë gjithë vitit nëse ndodh ndonjë fatkeqësi? Ma thuaj me vlerë absolute të të them që ke të drejtë apo jo? Në të kundërt, hiqe 4%-in. Lere të hapur ose mbaje vetë si ministri dhe hajde në Kuvend të miratojmë fond në buxhetin e shtetit dhe je në rregull.

**Ulsi Manja** – Zoti Koçi, fill pas fjalës suaj do ta hedh në votim.

**Petro Koçi** – Është i hapur, 4%-i është dyshemeja. Reagimi është proporcional. Nëse do të ketë fatkeqësi natyrore vendore, e cila e kalon përmasën e përgjegjësive dhe kapacitetit financiar dhe të instrumenteve të tjera të qeverisë vendore, do të ndërhyjë qeveria. Nuk diskutohet.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zoti Koçi!

Ka pyetje apo diskutime të tjera?

Nuk ka.

Zoti Shameti, kemi ardhur te propozimi juaj për ta kaluar në votim.

E hedhim në votim në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për mbrojtjen civile”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Zoti Koçi, zoti Çako dhe kolegët që ju shoqërojnë, ju falënderoj për prezencën!

Ju uroj një ditë të mbarë!

Vazhdimi i shqyrtimit dhe i miratimit nen për nen i këtij projektligji do të bëhet në mbledhjen e radhës.

Mirupafshim!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 08.07.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

## **Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për rininë”.

### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Ediola Braha, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Korab Lita dhe Elena Xhina

### **Mungojnë:**

Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Damian Gjijnuri, Alban Zeneli, Elda hoti dhe Tom Doshi

### **Të ftuar:**

Zamira Gjini – Drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Erzen Tola – Drejtor i Programimit të Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Florian Nurçe - Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Matilda Bulku – Specialiste e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Bekim Murati – Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në Ministrinë e Brendshme

**Ulsi Manja** - Kalojmë në pikën e tretë dhe të fundit të rendit të ditës, shqyrtimin dhe miratimin në parim të projektligjit “Për rininë”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relatore është kolegja Vasilika Hysi. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, zoti Erzen Tola, Drejtor i Programimit të Standardizimit dhe Harmozimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe stafi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë që e shoqëron, ndërsa nga Ministria e Brendshme i pranishëm është zoti Bekim Murati, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore.

Mirë se erdhët në komision!

Në cilësinë e propozuesit të projektligjit, pra është një projektligj i ardhur nga Këshilli i Ministrave, do t’ju lutesha të na bëni një prezantim të shkurtër të këtij projektligji, sepse sot do ta miratojmë në parim projektligjin, ndërsa vazhdimin e shqyrtimit dhe miratimin nen për nen do ta kemi në një mbledhje tjetër të Komisionit të Ligjeve. Menjëherë pas prezantimit do t’ia kaloj fjalën koleges Vasilika Hysi, duke shpresuar që edhe ajo të jetë koncize në relatimin e saj për kolegët e komisionit, sepse sot siç jua thashë që në fillim të mbledhjes është një ditë e ngjeshur pune për deputetët, pasi në orën 17:00 kemi seancë plenare.

Fjala për ju zoti Tola.

**Erzen Tola** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë,

Ministria e Arsimit ka hartuar projektligjin “Për rininë”, të cilin e ka paraqitur pranë Këshillit të Ministrave dhe ky projektligj është miratuar me vendimin nr. 281, datë 10.05.2019...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** - Ministrja na kërkoi ndjesë.

Mund të vazhdoni zoti Tola.

**Erzen Tola** – Projektligji përbëhet nga 6 krerë dhe 20 nene. Në kreun I trajtohen dispozitat e përgjithshme të projektligjit, në kreun II përcaktohet rrjeti rinor dhe të gjitha organet dhe strukturat e parashikuara nga ky projektligj, në kreun III përcaktohen punën rinore, në kreun IV trajtohen çështjet e financimit, sipas këtij projektligji, në kreun V infrastruktura rinore dhe në kreun VI janë dispozitat e fundit të projektligjit.

Shkurtimisht, duke u nisur edhe nga rëndësia e përmirësimit të legjislacionit në sektorin e rinisë, duke u bazuar edhe përvojat e identifikuara nga konsultimet me grupet e interesit u vlerësua

si shumë e domosdoshme hartimi dhe miratimi i nj projektligji për rininë, një projektligj, të cilin nuk e kanë të gjitha vendet e Bashkimit European.

Ligji është konsultuar, sipas ligjit për konsultimin publik, me të gjitha qarqet, madje Ministria e Arsimit ka dërguar grupin e hartimit të ligjit, të cilët janë konsultuar me të gjitha bashkitë, si dhe me rreth 3000 e më shumë të rinj.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Tola!

A ka ndonjë gjë për të shtuar përfaqësuesi i Ministrisë së Brendshme?

**Bekim Murati** – Ne kemi kërkuar që, sipas ligjit nr. 139, t'i qëndrojmë besnik këtij ligji, sepse kjo është alfa, për veprimtarinë e agjencisë dhe për pjesën e Ministrisë së Brendshme për pushtetin vendor në mënyrë që të kemi fonde të dedikuara për këtë çështje, të cilat duhet t'i delegohen pushtetit vendor për çështjen e rinisë, me mbështetje financiare.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zoti Murati!

Unë po ia kaloj fjalën reatores, zonjës Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar koleg,

Ky është një ligj i ri në llojin e tij, sepse nuk kemi pasur një ligj të tillë më parë, i cili synon mbrojtjen e të drejtave të të rinjve. Hartimi i këtij ligji ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së kuadrit ligjor për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve, si dhe përcaktimit të detyrimeve që duhet të kenë institucionet në nivel vendor dhe qendror.

Sipas relacionit projektligji paraqet risi. Ai prezanton mekanizmat për fuqizimin e të rinjve; trajton konceptimin ndaj edukimit joformal për të rinjtë; përcakton rolin dhe përgjegjësinë e autoriteteve përgjegjëse në nivel vendor dhe qendror; rregullon kriteret e organizatave rinore për bashkëpunimin e tyre me organet e qeverisjes vendore e qendrore; parashikon mundësinë e financimit të politikave, programeve dhe veprimtarive rinore, duke vënë theksin te kontributi i buxheteve vendore, si dhe mundësinë e krijimit të një infrastrukture për zhvillimin e aktiviteteve rinore.

Nuk do të doja të ndalesha tek impakti ekonomik dhe social që ka ligji, pasi ai ka një rëndësi shumë të madhe për ofrimin e shërbimeve për të rinjtë, të cilat janë të nevojshme në nivel qendror e vendor, por sidomos në nivelin vendor, rëndësinë që ka krijimi i këshillave rinore vendore për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje. Nga ana tjetër do të doja të theksoja që në

diskutimin e këtij projektligji dhe në hartimin relacionit së bashku me këshilltarët e komisionit dhe me zonjën Koka, kemi pasur parasysh Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, objektivat sociale, Kartën Sociale Europiane, dy rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, njëra e vitit 2015, me numër 3, për aksesin e të rinjve nga grupet e pafavorizuara në të drejtat sociale dhe rekomandimin e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Europës të vitit 2016, për aksesin e të rinjve në të drejtat e tyre.

Nuk do të ndalem në diskutimin nen për nen, por do të ngre disa çështje në parim, për të cilat do të kërkoja përgjigje nga përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, por edhe nga Ministria e Brendshme, por nëse do të kërkonte kohë të mjaftueshme për dhënien e përgjigjeve ju mirëkuptoj.

Çështja e parë që do të doja të diskutoja është fakti, pasi gjatë diskutimit në parim të këtij projektligji mendoj se është e nevojshme të sqarohen disa çështje. Cilat kanë qenë problematikat që keni hasur deri më sot në praktikë që e bën të detyrueshme pasjen e një ligji të posaçëm për rininë?

Në ligj sugjerojmë të krijohen disa mekanizma në nivel vendor dhe qendror. Çfarë efektiviteti pritet të ofrojnë mekanizmat dhe strukturat e propozuar?

Sa janë reflektuar në këtë nismë detyrimet që burojnë nga rekomandimet përkatëse të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës lidhur me rolin e të rinjve në shoqëri? Në vlerësimin tuaj a janë ato në përputhje me standardet ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve? Ky është grupi i parë i pyetjeve.

E dyta. Projektligji në përmbajtjen e tij ka parashikuar shtimin e funksioneve të organeve të vetëqeverisjes vendore. Kam studiuar me vëmendje ligjin nr. 139/2015 dhe konstatohet se njësisive të qeverisjes vendore u jepen kompetenca ekstra, ato të parashikuara në nenet 23 dhe 29. Por, bazuar në nenin 22, pika 2, të ligjit për vetëqeverisjen vendore dhe nenin 30, por edhe në Kartën e Autonomisë Vendore, do t'ju sugjeroja që nëse do të lihet në fuqi dhënia e këtyre kompetencave, në ligj duhet parashikuar plotësisht se qeverisja vendore duhet t'u garantojë njësisive të qeverisjes vendore mbështetje të nevojshme financiare në ushtrimin e këtyre funksioneve, pra fonde të dedikuara të rinjve. Pyetja ime është: a jeni konsultuar me organet dhe shoqatat e bashkive dhe cili është opinionimi i tyre? Do të doja të kisha një opinion të konsultimit të bërë me bashkitë.

E dyta, a keni bërë një vlerësim të mundësive që kanë njësitë e qeverisjes vendore, të kapaciteteve njerëzore dhe financiare që ata kanë? A është e mundur kjo apo do të vazhdojmë t'i përcillen organeve të qeverisjes vendore kompetenca pa fund dhe paratë nga taksapaguesit dhe

taksat që duhet t'u shtojnë banorëve të tyre? Në këtë kuadër nëse keni ndonjë dokument me shkrim të konsultimit për organet e qeverisjes vendore, dua të di se cili është opinioni i tyre? Më pas kur të vijmë në diskutimin nen për nen kam disa mendime dhe sugjerime konkrete.

Së treti, në projektligj parashikohet të njihet nga ministria përgjegjëse një organizatë e vetme si përfaqësuese kombëtare e organizatës rinore e përbërë nga 30 organizata rinore me 1000 anëtarë të paktën dhe që mbulojnë 70% të terrorit të bashkive. Dua të di cili është modeli dhe ku e keni gjetur atë? Në Kushtetutë thuhet që shtetasit kanë lirinë për t'u grumbulluar dhe organizuar, pra të jenë të lirë dhe unë besoj që secili grup ka të drejtë të dëgjohet, të ketë akses në informacion dhe në rast se plotëson kriteret e regjistrimit në gjykatë, sepse shoqatat regjistrohen në gjykatë, të aplikojë në bazë të fondeve e të tjera.

Pra, do të doja modelin ku e keni gjetur dhe cili është opinioni i të gjithë atyre 3000 personave që ju keni konsultuar? Në këtë këndvështrim neni 46 i Kushtetutës dhe ky ndryshim a janë proporcionalë? Pra, liria e organizimit nga njëra anë dhe nga ana tjetër nevoja për të njohur vetëm një organizatë kombëtare. Çfarë do të bëhet me organizatat e tjera, në qoftë se ka më shumë se një, të cilat kanë mbi 1000 anëtarë? Kë do njihni ju?

Çështja e katërt ose grupi tjetër i pyetjeve janë çështje që lidhen me infrastrukturën rinore. Më vjen shumë mirë që në nivelin vendor dhe qendror dedikohet një infrastrukturë e posaçme vetëm për rininë, për aktivitetet e saj e të tjera. Do të doja të dija nëse ju keni parasysh që në fuqi janë dy ligje, ligji nr. 8743 i vitit 2001, i cili parashikon përdorimin e pronave të paluajtshme të transferuara në administrim dhe ligji nr. 8744, i vitit 2001, i cili flet pikërisht për mënyrën se si njësitë vendore përdorin pronat e transferuara dhe të administruara. Ka një ligj për prokurimet publike dhe shërbimet, po ashtu ka edhe një ligj tjetër për planifikimin e zhvillimit të terrorit. Në këtë ligj, që është depozituar, këto katër ligje nuk merren në konsideratë, por sugjerohet që të ketë rregulla specifike për administrimin e pronës, për investimet, për prokurimet e kështu me radhë. Cila është arsyeja?

Zoti kryetar, në këtë kuadër ligji ka një sërë problemesh që kërkojnë të adresohen me kujdes, me vëmendje në harmoni me të gjitha. ligjet e tjera unë do të doja që në varësi të përgjigjeve që do të marr nga pyetjet, të vendosim për ecurinë e trajtimit të ligjit në komision.

Faleminderit!

**Ulsi Manja**- Unë jam dakord me pyetjet që ju bëni, por edhe kolegët e tjerë mund të kenë pyetje, por është e rëndësishme që sot të biem dakord që ky ligj të votohet në parim.



Pra, NGA sa u tha nga përfaqësuesit e qeverisë, jemi ndër 10 vendet lider që propozojmë të miratojmë një ligj të tillë. Edhe fakti që është futur në programin e punës së komisionit, por edhe të Kuvendit, sapo ka ardhur nga qeveria, tregon për rëndësinë që qeveria i kushton rinisë.

Sot kemi prezent në komision një nga deputetët e grupit tonë parlamentar, që është përfaqësues i rinisë, zoti N. Elio Hyskaj, që ka ardhur ta ndjekë në komisionin tonë këtë projektligj edhe pse jemi komision për dhënie mendimi.

Tani, unë kërkoj që sot, përveç pyetjeve të relatores Hysi, kolegët të parashtrojnë edhe pyetje të tjera për t'i mbajtur shënim përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit dhe të Ministrisë së Brendshme dhe, nëse do të biem dakord që përgjigjet e pyetjeve që do të bëhen sot t'i marrim në mbledhjen e radhës së Komisionit të Ligjeve, unë propozoj këtë variant të ecurisë së mbledhjes së komisionit.

Nëse ka mendim tjetër që ta ezaurojmë edhe fazën e pyetje- përgjigjeve dhe diskutimeve, jemi dakord.

Zoti Braho për pyetje.

**Spartak Braho** - Ky ligj hyn në fuqi qershorin e ardhshëm. Nuk e di ku është urgjenca? Unë jam dakord ta bëjmë, por në qershor hyn në fuqi.

**Ulsi Manja** – Unë jam shumë dakord.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Çfarë përfaqësojnë këto që kanë ardhur këtu? A përfaqësoni ministrinë ju?

Mund të vazhdoni me përgjigjet e zonjës Hysi dhe pastaj çfarë keni komunikuar me ministrin.

**Erzen Tola**- Lidhur me pyetjet e drejtuara nga relatorja e ligjit, ne konsiderojmë që duhet t'i shikojmë më me kujdes, sepse pyetjet ishin shumë, prandaj duhet të përgatisim një material të shkruar për të qenë më të qartë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Në këndvështrimin tonë, projektligjin e kemi në rregull.

**Ulsi Manja**– Në këndvështrimin tuaj, nuk është kurrkund projektligji.

A ka pyetje të tjera?

Përfaqësuesit e ministrisë kërkojnë kohë, edhe relatorja bashkohet me këtë mendim, sepse ligji ka nevojë të kolaudohet më tepër, dhe nuk e di kur qenka ezauroar me këtë projektligj kjo faza e konsultimit publik. Nëse ka nevojë relatorja dhe nëse kanë nevojë ministrinë të konsultohen

me ligjin, patjetër do t'i nis një shkresë qeverisë që, nëse ky projektligj nuk është konsultuar sa dhe si duhet, do të vëmë në dijeni propozuesit.

**Bekim Murati** – Projektligji është konsultuar në nivel vendor në të gjitha bashkitë, ka kaluar të gjithë procedurën normale që do të duhet për aq kohë sa ka qenë e nevojshme. Bashkitë kanë përgatitur dhe sugjeruar ndryshime, që ia kanë propozuar Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, në rastin konkret për ligjin “Për rininë” dhe këto ndryshime janë reflektuar në draftin e paraqitur, me përjashtim të çështjes së financimit për të cilën ne kemi kërkuar që kjo kompetencë ose ky funksion i ri, që cili do të duhet t'i kalojë nivelit vendor, sipas nenit 30 si kompetencë e re, do të duhet të shoqërohet në fillim edhe me faturë financiare.

**Vasilika Hysi** – Unë, zoti kryetar, në cilësinë e relatores, e kam studiuar projektligjin dhe e kam parë atë në harmoni me standardet, prandaj parashtrova disa pyetje që kërkojnë përgjigje dhe, nëse përfaqësuesit e ministrisë duan kohë, unë jam dakord.

**Bashkim Fino**- Dua t'ju them, zoti kryetar, nuk e kam për këtë projektligj, por për atë që kaluam pak më parë, për mbrojtjen civile, të cilin kemi kohë për ta kaluar nen për nen. Për të gjitha ato pyetje dhe diskutime që bëjmë këtu, si kryetar i komisionit apo si nënkomision i pushtetit vendor të bëjmë një konsultim me organet e pushtetit vendor që, me ç'pashë, për ligjin për mbrojtjen civile nuk ishte bërë. Pra, ia vlen ta bëjmë nesër, pasnesër, të na japin mendime për ligjin për mbrojtjen civile që kur të vijmë te diskutimi nen për nen të jemi më të saktë, sepse ne po nxitohemi, duam ta kalojmë shpejt patjetër më 18 korrik dhe nuk pyesim organet e pushtetit vendor. E propozoj këtë, të shënohet në procesverbal.

**Ulsi Manja** - Unë të dy projektligjet...

**Bashkim Fino**- Te projektligji i fundit me ç'kuptoje unë duhen vetëm fondet, ndërsa te ligji i mëparshëm për mbrojtjen civile nuk janë thirrur fare organet e pushtetit vendor dhe kjo është absurde.

**Ulsi Manja** - Zoti Fino, shumë faleminderit!

Të nderuar kolegë, unë do ta mbyll mbledhjen unë, sepse kam përgjegjësi për procedurën dhe rregulloren.

Në të tria projektligjet që kishim sot ishim komision për dhënie mendimi, dhe ajo pjesë e punës së komisionit për të shqyrtuar bazën kushtetuese dhe harmonizimin e projektligjit me të gjithë kuadrin e legjisllacionit që kemi në fuqi, është detyrim i këtij komisioni, sipas Rregullosës së Kuvendit.

Nëse ju çmoni se për projektligjin për mbrojtjen civile, të cilin e miratuam në parim dhe e kemi lënë në një mbledhje të radhës ta shqyrtojmë dhe miratojmë nën për nën, keni nevojë për të mbledhur komisionin, si kryetar i nënkomisionit për pushtetin vendor, zoti Fino, mund ta mblidhni komisionin. Nëse duhet ta formalizoj me urdhër unë si kryetar komisioni mbledhjen e nënkomisionit, edhe e bëjmë, ndërsa për projektligjin për rininë jam dakord me zonjën Hysi, që është detyrë e këtij komisioni ta shqyrtojmë nga pikëpamja e përputhshmërisë me Kushtetutën dhe ligjet. Ky është detyrimi i komisionit, nuk është objekt i punës së nënkomisioneve projektligji për rininë, dhe, meqenëse kërkohet kohë edhe nga përfaqësuesit e ministrisë për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve, por edhe relatorja është dakord për ta parë më në detaje projektligjin për rininë, bashkohem edhe me mendimin e zotit Braho, ky ligj hyn në fuqi në qershor të vitit që vjen, pra keni lënë kohë për të bërë aktet ligjore, nuk kemi nevojë të jemi pararojë me projektligjin, por kemi nevojë të jemi pararojë me ligjet që zbatohen dhe japin produkt shpejt.

E shtyjmë për sot projektligjin për rininë dhe do të jemi në kontakt edhe me Ministrinë e Arsimit, edhe me Ministrinë e Brendshme për ta bërë pjesë të kalendarit, për ta shqyrtuar dhe miratuar në parim e më pas nën për nën projektligjin.

**Bashkim Fino-** Ju zbatoni Rregulloren si kryetar i komisionit, unë nuk të kërkova të mblidhni nënkomisionet, absolutisht jo, as të mbledhim organet e pushtetit vendor këtu, por ama na takon si komision, pavarësisht se nuk jemi përgjegjës për të jemi përgjegjës për ligjin për emergjencat civile, që një letër t'ubësh shoqatave të bashkive të japin mendimin përkatës se si e mendojnë ligjin e emergjencave civile.

**Ulsi Manja**- Patjetër.

**Bashkim Fino**- Unë dua këtë gjë para se ta votoj dhe kam të drejtë ta kërkoj.

**Ulsi Manja** - Do t'ia nis si kryetar komisioni dhe do t'ia sugjeroj edhe relatores ta bëjë këtë shkresë.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

